




**MINISTÈRE
DE L'INTÉRIEUR**

*Liberté
Égalité
Fraternité*

MINISTRIA E BRENDSHME

**Drejtoria e përgjithshme e të
huajve në Francë**



Udhërrëfyesi i azilkërkuesit në Francë



PËRMBAJTJA

1. Format e ndryshme të mbrojtjes	4
1.1. Statusi i refugjatit.	4
1.2. Mbrojtja e dorës së dytë.	4
2. Aksesit në procedurë dhe regjistrimi i kërkesës së azilit.....	5
2.1. Pritja fillestare e azilkërkuesve	5
2.2. Regjistrimi i kërkesës së azilit në sportelin unik.....	6
2.2.1. Etapa e parë : regjistrimi i kërkesës suaj të azilit nga prefektura.	6
■ Përcaktimi i shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit.	6
■ Cilësimi i kërkesës suaj të azilit.....	7
■ Zgjedhja e gjuhës për intervistën në OFPRA.	8
■ Lëshimi i dëshmisë së kërkesës së azilit.	9
■ Mundësia për të kërkuar një pranim për qëndrim për arsye të tjera përveç azilit.	10
2.2.2. Etapa e dytë : vlerësimi i nevojave dhe marrja përsipër nga OFII.	10
■ Marrja parasysh e nevojave tuaja të veçanta nga sporteli unik.....	10
■ Oferta e marrjes përsipër.	11
2.3. Shoqërimi pas kalimit në sportelin unik.....	11
3. Kushtet e shqyrtimit të kërkesës së azilit	12
3.1. Shqyrtimi nga Zyra franceze e mbrojtjes së refugjatëve dhe personave pa shtetësi (OFPRA) 12	
■ Formulari i OFPRA-s për tu plotësuar.....	12
■ Dërgimi i dosjes në OFPRA.	12
■ Prova e regjistrimit të kërkesës nga OFPRA.	13
■ Shqyrtimi i kërkesës në procedurë normale ose në proceure të përshpejtuar.....	14
■ Intervista personale në OFPRA.....	14
■ Vizita mjekësore.	15
■ Vendimi i OFPRA-s.....	15
■ Ankesa kundër vendimit të OFPRA-s.....	17
■ Fundi i të drejtës për qëndrim që nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s.....	17
3.2. Shqyrtimi nga Gjykata kombëtare e të drejtës së azilit (CNDA).	17
■ Afati i ankesës.....	18
■ Asistenca nga një avokat.	18
■ Ankesa.	19
■ Dëshmia e marrjes së ankesës.	20
■ Karakteri pezullues i ankesës.....	20
■ Marrja në pyetje në CNDA.....	21
■ Vendimi i CNDA-s.	22
■ Fundi i të drejtës për qëndrim pas vendimit të CNDA-s.....	22
3.3. Rihapja e një kërkesë azili të mbyllur.	22
3.4. Rishqyrtimi.	23
4. Kushtet materiale të pritjes së kërkuesit dhe të drejtat e tij	25
4.1. Strehimi i azilkërkuesit.	25
■ Vendet e strehimit.	25



■ Orientimi drejt strehimit.....	26
■ Pranimi dhe largimi nga vendi i strehimit.....	26
4.2. Ndhimja financiare për azilkërkues (ADA).....	27
■ Kushtet për të përfituar nga ndihma.....	27
■ Formulari i kërkesës.....	27
■ Shuma e ndihmës financiare.....	28
■ Derdhja e ndihmës.....	28
■ Ankesa.....	28
4.3. Aksesi në shkollim.....	29
4.4. Aksesi në shëndetësi.....	29
■ Ku mund t'i gjeni shërbimet shëndetësore ?.....	29
■ Si të fitoni marrjen përsipër të shpenzimeve tuaja shëndetësore ?.....	30
4.5. Aksesi në tregun e punës.....	32
5. Pasojat e refuzimit të kërkesës së azilit mbi të drejtat e qëndrimit në territor.....	33
5.1. Vendimi i refuzimit nga OFPRA ose nga CNDA.....	33
■ Fundi i të drejtës për qëndrim që nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s.....	33
■ Fundi i të drejtës për qëndrim që nga leximi ose njoftimi i vendimit të CNDA-s.....	35
5.2. Ndhimja për kthimin në vendin e prejardhjes.....	35
5.3. Kthimi i detyruar në vendin e prejardhjes.....	36
6. Të drejtat e përfituesve të një mbrojtje.....	37
6.1. Qëndrimi në Francë.....	37
6.2. Qëndrimi i familjes.....	37
■ E drejta për qëndrim e anëtarëve të familjes suaj.....	37
■ E drejta e ribashkimit familjar.....	37
6.3. Integrimi.....	39
■ Nënshkrimi i kontratës së integritit republikan me Zyrën franceze të imigracionit dhe integritit (OFII).....	39
6.4. Të drejtat sociale.....	39
■ Aksesi në banesë.....	39
■ Aksesi në tregun e punës.....	40
■ Aksesi në shëndetësi.....	40
■ Ndhimat sociale dhe familjare.....	41
6.5. Udhëtimi jashtë shtetit.....	41
6.6. Natyralizimi.....	42
6.7. Fundi i mbrojtjes.....	42
SHTOJÇË : adresa të dobishme.....	44
1. Adresa në shkallë vendi.....	45
■ Institucione.....	45
■ Organizata ndërkombëtare.....	45
■ Shoqata.....	45
2. Adresa vendore.....	48
■ Sportele unike.....	45
■ Prefektura.....	50
■ Drejtori territoriale të Zyrës franceze të imigracionit dhe integritit (OFII).....	55



1. Format e ndryshme të mbrojtjes

Kur ju paraqisni një kërkesë azili dhe kur shqyrtimi i saj është në përgjegjësinë e Francës, kërkesa juaj shqyrtohet nga një autoritet i mbrojtjes, Zyra franceze e mbrojtjes së refugjatëve dhe personave pa shtetësi (OFPRA), nën kontrollin gjyqësor të Gjykatës kombëtare të drejtës së azilit (CNDA).

Mbas shqyrtimit të kërkesës së azilit, autoritetet e mbrojtjes mund t'ju japin një mbrojtje në kuadër të azilit : ose ju njihet statusi i refugjatit, ose ju jepet mbrojtja e dorës së dytë.

1.1. Statusi i refugjatit.

Statusi i refugjatit mund t'ju jepet mbi këto tre baza themeltare :

- **konventa e Gjenevës** lidhur me statusin e refugjatëve e 28 korrikut 1951. Statusi i refugjatit i jepet « çdo personi i cili (...) duke pasur frikë me të drejtë nga persekutimi për shkak të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë ndaj një grupi të caktuar shoqëror ose opinionëve të veta politike, ndodhet jashtë vendit shtetas i të cilit është dhe nuk mund ose, për shkak frikës së lartpërmendur, nuk dëshiron t'i kërkojë mbrojtje » ;
- **azili i quajtur « kushtetues »**, i cili buron nga paragrafi 4 i preambulës së Kushtetutës të vitit 1946. Statusi i refugjatit i jepet « çdo personi të persekutuar për shkak të veprimtarisë së tij në favor të lirisë » ;
- **mandati i Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (HCR)** : nëse ju jeni njohur si refugjat nga HCR, në bazë të nenve 6 dhe 7 të statutit të tij.

1.2. Mbrojtja e dorës së dytë.


Përfitimi i mbrojtjes së dorës së dytë i jepet çdo personi që nuk i përmbush kushtet për t'u njohur si refugjat por për të cilin ekzistojnë arsye serioze dhe të vërtetuara për të besuar se ai i ekspozohet, në vendin e tij, një rreziku të vërtetë të vuaj një nga cënimet e rënda në vijim:

- dënim me vdekje ose ekzekutim ;
- torturë apo ndëshkime ose trajtime çnjerëzore apo poshtëruese ;
- për një person civil, kërcënim i rëndë dhe individual kundër jetës së tij ose personit të tij për shkak të një dhune që mund të përhapet ndaj personave pa marrë parasysh gjendjen e tyre personale dhe si rezultat i një situatë konflikti të armatosur të brendshëm ose ndërkombëtar.

Statusi i personit pa shtetësi

Sipas Konventës së Nju Jorkut të 28 shtatorit 1954 mbi statusin e personave pas shtetësi, statusi i personit pa shtetësi mund t'i jepet çdo personi « që asnjë shtet nuk e konsideron si shtetas të vetin sipas të legjislacionit të vet ».

Ky status dallon nga dy format e tjera të mbrojtjes të përshkruara më lart dhe nuk ka të bëjë me procedurën e kërkesës së azilit. Pra ju nuk duhet t'i drejtoheni prefekturës, por t'i drejtoheni drejtpërdrejt OFPRA-s, e cila, pas shqyrtimit të kërkesës suaj, mund t'ju japë këtë status, nën kontrollin juridiksional të gjykatës administrative.



2. Akses në procedurë dhe regjistrimi i kërkesës së azilit

Për të bërë një kërkesë azili në Francë, duhet që paraprakisht t'i drejtoheni një strukturë pritje fillestare për azilkërkuesit (SPADA), e cila do t'ju informojë mbi procedurën e azilit dhe do t'ju japë një takim në sportelin unik të azilkërkuesve kompetent në nivelin territorial.

Sporteli unik është i ngarkuar të regjistrojë kërkesën tuaj të azilit, të përcaktojë procedurën nën varësinë e të cilës jeni, të vlerësojë prekshmërinë tuaja dhe t'ju caktojë, nën disa kushte, kushtet materiale të pritjes (strehimin, ndihmën financiare për azilkërkuesit).

Nën cilat kushte qëndrimi mund të parashtroni një kërkesë azili ?

Ju mund të kërkonte azilin pavarësisht situatës suaj sipas të drejtës së qëndrimit, qoftë kjo nëse jeni në situatë të rregullt ose të parregullt. Fakti që ju keni hyrë në mënyrë të parregullt në Francë nuk pengon regjistrimin e kërkesës suaj të azilit.

Ju këshillohet të regjistroni kërkesën tuaj të azilit në një afat sa më të shkurtër mbas hyrjes në territorin francez, këtë edhe pse keni hyrë në Francë i pajisur me vizë e cila është akoma e vlefshme. Nëse kërkesa juaj nuk parashtrohet brenda një afati prej 90 ditësh duke u nisur nga hyrja juaj në Francë, marrja përsipër mund t'ju refuzohet.

2.1. Pritja fillestare e azilkërkuesve.

Para se të shkoni te sporteli unik për azilkërkues (GUDA), ju duhet të paraqiteni pranë një strukturë të pritjes fillestare të azilkërkuesve (SPADA). Këto struktura të pritjes fillestare, në përgjithësi të administruara nga shoqata, janë të ngarkuara t'ju shoqërojnë në përçapjet tuaja me qëllim që të keni akses në procedurën e azilit.


Operatorët të ngarkuar për pritjen fillestare kanë për mision :

- t'ju informojnë mbi procedurën e azilit ;
- të plotësojnë, mbi bazën e informacioneve mbi situatën tuaj, formularin në linjë i cili do të shërbejë për regjistrimin e kërkesës suaj të azilit ;
- të marrin takim në sportelin unik dhe t'ju dorëzojnë një fletëthirrje. Kjo e fundit do t'ju tregojë vendin, ditën dhe orën në të cilat ju duhet medoemos të paraqiteni te sporteli unik. Ky takim bëhet në përgjithësi 3 ditë maksimum mbas paraqitjes suaj pranë operatorit. Ai mund të zhvendoset mbas 10 ditësh në rast se ka shumë kërkesa ;
- të marrin fotografi identiteti të cilat do t'ju kërkohen në sportelin unik.

E gjithë dosja juaj i transmetohet sportelit unik me rrugë të çmaterializuar.

KUJDES : Ju duhet medoemos të respektoni datën dhe orën që figurojnë mbi fletëthirrje. Në rast vonese, ju nuk mund të pritni dhe do t'ju duhet në këtë rast të paraqiteni edhe një herë pranë strukturës së pritjes fillesatre për të marrur një takim të ri.

Vini re, SPADA-t do të jenë gjithashtu të ngarkuara t'ju japin vendbanim postar nëse nuk keni marrë strehim në Qendrën e Pritjes për Azilkërkues (CADA) ose çdo strukturë tjetër strehimi të qëndrueshme për azilkërkues mbas regjistrimit tuaj në sportelin unik (shih rubrikën « Si të dëshmoni për adresën tuaj ? në pjesën 2.2.1).



2.2. Regjistrimi i kërkesës së azilit në sportelin unik.

Për të regjistruar kërkesën tuaj të azilit, ju duhet të shkoni në sportelin unik, sipas fletëthirrjes që ju është dorëzuar nga SPADA (shih 2.1.).

Sporteli unik përbëhet nga punonjës të prefekturës dhe nga punonjës të Zyrës franceze të imigracionit dhe integritetit (OFII), të mbledhur aty posaçërisht për të siguruar pritjen tuaj.

Ekzistojnë 33 sportele unike të shpërndarë në të gjithë territorin metropolitan (ju mund të konsultoni listën në shtojcë).

Takimi në sportelin unik zhillohet në dy etapa :

- një etapë e parë pranë punonjësve të prefekturës, për regjistrimin e kërkesës suaj (2.2.1) ;
- një etapë e dytë pranë punonjësve të OFII-t, për të vlerësuar nevojat tuaja të veçanta dhe për të përkufizur modalitetet e marrjes suaj përsipër (2.2.2).

A duhet të keni një adresë postare për regjistrimin e kërkesës suaj të azilit ?

Nuk është e nevojshme që ju të dispononi një vendbanim (adresë postare) për regjistrimin e kërkesës suaj të azilit.

Por, kjo do të jetë e nevojshme për përtëritjen e dëshmisë suaj të kërkesës së azilit (shih rubrikën « lëshimi i dëshmisë së kërkesës së azilit » në pjesën 2.2.1).

2.2.1. Etapa e parë : regjistrimi i kërkesës suaj të azilit nga prefektura.

Ju jeni të shoqëruar nga fëmijët tuaj të mitur ?


Nëse jeni të shoqëruar nga fëmijët tuaj në moshë të mitur, këta të fundit do të konsiderohen si azilkërkues dhe do të regjistrohen në dëshminë tuaj të kërkesës së azilit. Nëse të dy prindërit janë azilkërkues, të miturit do të regjistrohen në dëshminë e nënës së tyre, e cila konsiderohet si prindi referent gjatë gjithë procedurës. Ky dokument nuk vërteton përbërjen e familjes suaj por kërkesat e azilit në kryerje e sipër.

■ Përcaktimi i shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit.

Pasi të ketë bërë të vlefshme të gjitha informacionet të përcjellura sportelit unik nga struktura e pritjes fillestare, një punonjës i prefekturës do të përcaktojë nëse Franca është përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit.

Për këtë, nëse ju jeni 14 vjeç ose më shumë, ai merr dhjetë shenjat e gishtave tuaj dhe realizon një takim individual i cili shërben gjithashtu për të rivizituar rrugëtimin tuaj që nga vendi juaj i prejardhjes, dhe për të treguar lidhjet e mundshme, për shembull familjare, që ju mund të keni në shtete të treja anëtare të Bashkimit evropian.

Mbi bazën e të gjithë këtyre elementeve do të përcaktohet vendi përgjegjës i kërkesës suaj të azilit në zbatim të rregullores n°604/2013 të Parlamentit evropian dhe Këshillit të 26 qershorit 2013, e ashtuquajtura rregullore Dublin III.



Shtetet që kanë të bëjnë me dispozitivin Dublin III

Bëhet fjalë për 28 anëtarët e Bashkimit europian : Gjermania, Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Danimarka*, Spanja, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Republika Çeke, Rumania, Mbretëria e Bashkuar, Sllovakia, Sllovenia, dhe Suedia dhe katër shtetet bashkëpunëtorë : Islanda, Norvegjia, Zvicra dhe Lihtenshtajni.

* Danimarka nuk i nënshtrohet Rregullores « Dublin III », por vazhdon të zbatojë Konventën e Dublinit, të nënshkruar më 15 qershor 1990.

Në fakt, është e mundur që jo Franca por një tjetër shtet europian të jetë përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit, për shembull :

- nëse një shtet tjetër anëtar ju ka lëshuar leje qëndrimi ose vizë që është akoma e vlefshme ;
- nëse vertetohet që keni kaluar në mënyrë të parregullt, me anë të rrugëve tokësore, ajrore ose detare, kufirin e jashtëm të një vendi tjetër anëtar ;
- nëse keni hyrë në territorin e Bashkimit europian duke i kaluar së pari kufijtë e një vendi anëtar në të cilin nuk ju duhet vizë ;
- nëse keni kërkuar tanimë azil në një tjetër shtet anëtar.

Shqyrtimi i kërkesës suaj të azilit mund të jetë në përgjegjësinë e një tjetër shteti anëtar ?


Procedura e ashtuquajtur « Dublin III » shpalolet. Atëherë prefektura do të ndërmarrë përçapje pranë këtij shteti për t'i kërkuar që t'ju marrë përsipër. Në këtë rast do t'ju jepet një dëshmi azilkërkuesi, për një kohëzgjatje prej një muaji, pastaj prej katër muajsh me mundësi përtëritje, e cila ju autorizon të qëndroni në territorin francez deri në transferimin tuaj drejt shtetit i cili ka njohur përgjegjësinë e tij.

Ky transferim do të organizohet nga shërbimet e prefekturës të cilat do t'ju njoftojnë për vendimin e transferimit i cili saktëson modalitetet e nisjes suaj. Ju do të keni një afat prej 15 ditësh për të kundërshtuar këtë vendim para gjykatës administrative.

■ Cilësimi i kërkesës suaj të azilit.

Nëse shqyrtimi i kërkesës suaj të azilit është në përgjegjësi të Francës, OFPRA është organi kompetent për t'a shqyrtuar atë, në procedurë normale ose në procedurë të përshpejtuar. Në procedurë të përshpejtuar, afatet e shqyrtimit nga OFPRA janë të shkurtuara, zakonisht në pesëmbëdhjetë ditë por garancitë janë të njejtat në të dyja procedurat.

- **Kërkesa juaj vendoset automatikisht në procedurë të përshpejtuar**, që nga sporteli unik, në dy raste :
 - kur këni kombësinë e një vendi i cili konsiderohet si vend me prejardhje të sigurtë (lista e këtyre vendeve e disponueshme në prefekturë ose në faqen internet të OFPRA-s) ;
 - kur keni bërë një kërkesë të parë azili e cila është refuzuar përfundimisht dhe ju kërkonit rishqyrtimin e kërkesës suaj.



- **Kërkesa juaj vendoset automatikisht në procedurë të përsheptuar**, që nga sporteli unik, në këto raste :
 - nëse refuzoni që të merren shenjat e gishtave tuaj ;
 - nëse përpigëni të ngatëroni autoritetet duke prezantuar dokumente të rreme, duke dhënë indikacione të rreme ose duke fshehur disa informacione ;
 - nëse keni prezantuar kërkesa të shumta nën identitete të ndryshme ;
 - nëse keni vonuar për të kërkuar azilin që nga momenti i hyrjes suaj në Francë (më shumë se 90 ditë dhe 60 ditë në Guyane) ;
 - nëse kërkoni azilin me qëllimin e vetëm për të shmangur një masë largimi ;
 - nëse prezenca juaj përbën një kërcënim të rëndë për rendin publik, sigurinë publike ose sigurinë e shtetit.

OFPPA ka aftësinë të riklasifikojë në procedurë normale një kërkesë të vendosur në procedurë të përsheptuar gjatë regjistrimit, përveç rastit kur kërkesa është vendosur në procedurë të përsheptuar për arsye të rendit publik.

Nëse kërkesa juaj e azilit është vendosur në procedurë të përsheptuar, një udhëzim informacioni do t'ju jepet në disa kopje. Duhet që t'i dërgoni një kopje OFPPA-s në momentin e parashtrimit të kërkesës suaj, dhe një kopje CNDA-s nëse ju bëni një ankesë kundër vendimit të OFPPA-s.

Raste të veçanta : kundër jush ka masë dëbimi, ndalimi territori i shpallur nga një administratë ose një gjykatë ?

Fakti që kundër jush ka pasur një masë të tillë largimi nuk përbën pengesë për regjistrimin e kërkesës suaj të azilit.

Nëse shqyrtimi i kërkesës suaj është në përgjegjësinë e Francës, ju mund të detyrohëni të qëndroni në një vend të caktuar ose të vendoseni në një qendër mbajtjeje administrative.

Në këtë rast, OFPPA shqyrton kërkesën tuaj brenda një afati të shkurtuar (96 orë) mbas detyrimit tuaj për qëndrim në një vend të caktuar ose vendosjes në një qendër mbajtjeje administrative. Në rast refuzimi ose mospranimi, i jepet fund të drejtës suaj për qëndrim në territor. Ju mund, brenda 48 orëve, t'i kërkoni gjykatës administrativ të pezullojë ekzekutimin e masës së largimit gjatë kohës që CNDA të shqyrtojë ankesën tuaj (shih pjesën 5.1).

■ Zgjedhja e gjuhës për intervistën në OFPPA

Nëse shqyrtimi i kërkesës suaj të azilit është në përgjegjësinë e Francës, ju do të merreni në pyetje, pas parashtrimit të kërkesës suaj me shkrim OFPPA-s, dhe me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, nga OFPPA gjatë një interviste personale.

Në momentin e regjistrimit të kërkesës suaj të azilit, ju duhet të zgjidhni gjuhën në të cilën ju dëshironi të merreni në pyetje nga OFPPA. Pra do t'ju jepet një udhëzim i cili do t'ju informojë mbi gjuhët e dëgjimit të disponueshme në OFPPA, më shumë se 115 gjuhë. Ju nuk mund të modifikoni zgjedhjen tuaj më pas dhe gjuha e zgjedhur do të përdoret gjatë gjithë procedurës së shqyrtimit të kërkesës së azilit.

Nëse nuk keni zgjedhur mes gjuhëve të cituara në udhëzimin e informacionit, ju do të merreni në pyetje në një gjuhë që e njihni mjaftueshëm.

Nëse dëshironi të kundërshtoni zgjedhjen e gjuhës të përdorur gjatë procedurës suaj të azilit, ju mund ta bëni këtë vetëm në kuadër të ankesës e cila mund të kryhet para CNDA-s kundër vendimit të OFPPA-s për sa i përket kërkesës suaj të azilit.



KUJDES : kohëzgjatja dhe natyra e një interviste në OFPRA kanë nevojë për më shumë se një njohje të sipërfaqshme të një gjuhe. Është e rëndësishme që të kuptoni gjuhën që zgjidhni dhe të jeni të aftë të shprehni në këtë gjuhë.

■ Lëshimi i dëshmisë së kërkesës së azilit.

Pas përcaktimit të shtetit përgjegjës për kërkesën tuaj dhe kualifikimit të procedurës suaj të kërkesës së azilit, ju jepet një dëshmi kërkesë azili.

Kur shqyrtimi i kërkesës suaj mund të jetë në përgjegjësinë e një tjetër shteti anëtar, kohëzgjatja e vlefshmërisë së dëshmisë së parë është një muaj. Ajo mund të përtërihet për periudhë prej katër muajsh (shih rubrikën « përcaktimi i shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit » në pjesën 2.2.1).

Kur shqyrtimi i kërkesës suaj është në përgjegjësinë e Francës, ju jepet një dëshmi e parë kërkesë azili. Kjo dëshmi është e vlefshme :

- për një afat prej gjashtë muajsh kur kërkesa juaj shqyrtohet sipas procedurës normale ;
- për një afat prej gjashtë muajsh kur ajo shqyrtohet sipas procedurës së përshpejtuar.


Prefektura mund t'ju refuzojë lëshimin e dëshmisë së kërkesës së azilit vetëm në rastet në vijim :

- ju parashtroni një kërkesë të re rishqyrtimi pas refuzimit të një kërkesë të mëparshme rishqyrtimi (shih 3.4.) ;
- kundër jush ka një vendim përfundimtar ekstradimi drejt një vendi të ndryshëm me vendin tuaj të prejardhjes ose një vendim dorëzimi bazuar në një fjetëarrest të europian ose një kërkesë dorëzimi nga një gjykatë penale ndërkombëtare.

Në një afat prej 21 ditësh pas dhënies së dëshmisë (8 ditë në rast kërkesë rishqyrtimi ose rihapje, shih pjesët 3.3 dhe 3.4), ju duhet t'i dërgoni OFPRA-s formularin e kërkesës së azilit, i cili ju është dhënë nga prefektura, (shih 3.1 « shqyrtimi nga OFPRA »). Nëse dosja juaj është e plotë, OFPRA ju bën të ditur marrjen e saj me anë të një letre.

Për të arritur të merrni përtëritjen e parë të dëshmisë së kërkesës së azilit, duhet të paraqisni këtë letër në prefekturën e vendbanimit tuaj. Kjo dëshmi ka një vlefshmëri prej nëntë muajsh në procedurë normale ose prej gjashtë muajsh në procedurë të përshpejtuar. Në përtëritjen pasardhëse, dëshmia ka një vlefshmëri prej gjashtë muajsh në procedurë normale dhe prej tre muajsh në procedurë të përshpejtuar.

Në çdo kërkesë përtëritje, duhet të paraqisni në mbështetje të kërkesës suaj dokumentet e kërkuara nga prefektura, gjithashtu vërtetimin e adresës ku keni vendbanimin. Për të vërtetuar që keni kryer një ankesë pranë CNDA-s, duhet të paraqisni njoftim marrjen e ankesës (shih pjesën 3.2 « Shqyrtimi nga Gjykata kombëtare e të drejtë së azilit »).



Si të dëshmoni për vendbanimin tuaj ?

Për kërkesat e azilit të regjistruara duke u nisur nga 1 janari 2019, ju mund të dëshmoni për vendbanimin tuaj sipas modaliteteve në vazhdim :

- nëse jeni të strehuar në një qendër pritje për azilkërkues ose në çdo strukturë tjetër strehimi të qëndrueshme për azilkërkues (gjë që përjashton hotelet), duke dhënë një deklaratë vendbanimi ;
- nëse banoni në një banesë për të cilin jeni pronarë ose qiramarrës ose në një banesë që i përket/merret me qira nga bashkëshorti/bashkëshortja/fëmija/prindi juaj, duke dhënë një dokument vërtetues për vendbanim ;
- në raste të tjera, duhet të keni vendbanim në strukturë të pritjes fillestare me marrëveshje për këtë qëllim dhe të jepni një deklaratë vendbanimi (shih 2.1).

Për kërkesat e azilit të regjistruara para 1 janarit 2019, ju mund të vendstrehoheni sipas modaliteteve të përshkruara më lart por gjithashtu, në të tillë rast, të vazhdoni të vendstrehoheni tek një i tretë.

Kjo dëshmi kërkesë azili përtërihet gjatë gjithë kohës kur ju përfitonin nga e drejta e qëndrimit në territor. Në përgjithësi, ju përfitonin nga e drejta e qëndrimit gjatë të gjithë shqyrtimit të kërkesës suaj të azilit, deri në njoftimin e vendimit të OFPRA-s ose, në rast ankese para CNDA-s, deri në njoftimin e vendimit të saj ose, në të tillë rast, në leximin e vendimit gjatë seancës dëgjimore publike.

Megjithatë, dëshmia e kërkesës së azilit mund t'ju tërhiqet ose të mos ju përtërihet, kur :

- OFPRA ju ka vënë në dijeni për vendimin e refuzimit ose vendimin e papranueshmërisë së kërkesës suaj i cili sjell si pasojë fundin e të drejtës së qëndrimit në territor (shih 5.1 « Vendimi i refuzimit nga OFPRA ose CNDA ») ;
- duket qartë që afati i ankesës pranë CNDA-s nuk është respektuar (shih 3.2 « Shqyrtimi nga Gjykata kombëtare e të drejtës së azilit »).

KUJDES : Dëshmia e kërkesës së azilit nuk ju lejon që të qarkulloni lirisht në vendet e tjera të Bashkimit europian.

■ Mundësia për të kërkuar një pranim qëndrimi për arsye të tjera përveç azilit.

Nëse shqyrtimi i kërkesës suaj të azilit është në përgjegjësinë e Francës, ju do të informoheni mbi mundësinë për të kërkuar një leje qëndrimi për arsye të tjera përveç azilit.


Një udhëzim informacioni do t'ju jepet dhe ai do të saktësojë afatin në të cilin keni mundësinë të bëni këtë kërkesë. Kur ky afat kalon, nuk mund të kërkonin më pranim qëndrimi, nën rezervën e rrethanave të reja që do të justifikonin këtë.

2.2.2. Etapa e dytë : vlerësimi i nevojave dhe marrja përsipër nga OFII.

■ Marrja parasysh e nevojave tuaja të veçanta nga sporteli unik.

Gjatë kalimit tuaj në sportelin unik dhe pas regjistrimit të kërkesës suaj të azilit pranë prefekturës, një punonjës i OFII-t do t'ju presë personalisht me qëllim që të vlerësojë nevojat tuaja të veçanta për sa i përket ndihmës.

Biseda do të jetë e fshehtë dhe nuk mund të ketë lidhje me arsyet e kërkesës suaj të azilit. Një listë me pyetje do t'ju parashtrohet për të përcaktuar nëse keni nevojë të përfitonin nga kushte pritje specifike. Nëse gjendja juaj e kërkon një gjë të tillë, punonjësi i OFII-t do të marrë parasysh elementet në fjalë për t'ju orientuar drejt një vendstrehimi të përshtatshëm.



Jeni të lirë të pranoni ose të refuzoni t'i përgjigjeni pyetësorit. Në rast refuzimi, administrata nuk do të mund të mbajë përgjegjësi për orientimin drejt një strehimi që nuk do të ishte i përshtatshëm për nevojat tuaja ose për mos sinjalizimin mbi gjendjen tuaj OFPRA-s.

Nëse vini në Francë të pajisur me dosje mjekësore, punonjësi i OFII-t do të përcjellë dosjen tuaj në zarf të mbyllur mjekut të OFII-t i cili do të vendosë nëse situata juaj nevojitet një përshtaje të kushteve të pritjes. Nëse jeni i sëmurë, do të orientoheni drejt ndonjë strukture shëndetësore ose drejt shërbimit të urgjencës të spitalit më të afërt.

Nëse punonjësi i OFII-t zbulon ndonjë situatë prekshmerie, ai mund, me pëlqimin tuaj, të lajmërojë OFPRA-n. Ky informacion ka për qëllim përshtatjen, nëse është e nevojshme, e kushteve të shqyrtimit të kërkesës suaj të azilit nga OFPRA (për shembull, përshtatje të aketit për personat e handikapuar, ose vënia në dispozicion të një përkthyesi në gjuhën e shenjave). Është OFPRA ajo që do të vlerësojë përshtatjet e nevojshme.

Nevojat që kanë të bëjnë me gjendjen e prekshmerisë do të mund të merren parasysh gjatë gjithë shqyrtimit të kërkesës suaj të azilit nga punonjësit social në strukturat e strehimit ose nga shoqatat që kanë përsipër shoqërimin tuaj në përçapjet administrative dhe sociale.

■ Oferta e marrjes përsipër.

Gjatë takimit tuaj në sportelin unik, OFII do t'ju propozojë një ofertë marrje përsipër e cila do t'ju lejojë të përfitoni nga kushtet materiale të pritjes gjatë gjithë kohëzgjatjes të së drejtës suaj për qëndrim në territor në kuadër të azilit.

Dokumenti i marrjes përsipër që ju është dhënë nga OFII në sportelin unik dëshmon për përbërjen tuaj familjare me qëllim përcaktimin e nivelit të së drejtave për kushtet materiale të pritjes. Ky dokument botohet nga OFII përsëri kur një fëmijë lind ose bashkohet me prindërit gjatë procedurës me qëllim që të merret parasysh për llogaritjen e të drejtave në lidhje me kushtet materiale të pritjes. Ashtu si shpjegohet në pjesën 4 të këtij udhërrëfytyesi, kushtet materiale të pritjes ju japin të drejtën për :

- një vendstrehim drejt të cilit do të drejtoheni, nëse nuk jeni strehuar akoma dhe kërkonit një marrje përsipër (shih 4.1. « Strehimi i azilkërkuesit »).
- ndihmë financiare për azilkërkues, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme të parashikuara nga ligji (shih 4.2 « Ndhima financiare për azilkërkuesin »).

Në rast ngopje të strukturave të pritjes në një krahinë, OFII mund t'ju orientojë drejt një krahine tjetër, ku do të jeni të detyruar të banoni gjatë shqyrtimit të kërkesës Suaj (shih 4.1 « Strehimi i azilkërkuesit »).


2.3. Shoqërimi pas kalimit në sportelin unik.

Pas kalimit nga sporteli unik, një shoqërim do t'ju propozohet në vendstrehimin tuaj, nëse bëhet fjalë për një qëndër pritje për azilkërkues (CADA) ose vendstrehim urgjence i quajtur i qëndrueshëm (jo hotel).

Nëse nuk jeni strehuar në një vend të tillë, shoqërimi juaj do të sigurohet nga një strukturë e pritjes së parë (SPADA) drejt së cilës do t'ju orientojë OFII (shih pjesën 2.1).

Ky shoqërim social, juridik dhe administrativ përfshinë gjithashtu edhe vendbanimin tuaj postar (shih rubrikën « Si të dëshmoni për vendbanimin tuaj » në pjesën 2.2.1) dhe nëse shqyrtimi i kërkesës suaj të azilit është në përgjegjësinë e Francës, ndihmën për përbërjen e dosjes së kërkesës së azilit që duhet t'i dërgoni OFPRA-s.

KUJDES : Nëse vendbanimi juaj postar është në SPADA, keni përgjegjësinë të shkoni të tërhiqni postën tuaj shumë rregullisht, duke mbajtur parasysh udhëzimet e vendosura nga SPADA.



3. Kushtet e shqyrtimit të kërkesës së azilit.

Kur shqyrtimi i kërkesës suaj të azilit është në përgjegjësinë e Francës, ajo do të ekzaminohet nga Zyra franceze e mbrojtjes së refugjatëve dhe personave pa shtetësi, nën kontrollin gjyqësor të Gjykatës kombëtare të së drejtës së azilit.

3.1. Shqyrtimi nga Zyra franceze e mbrojtjes së refugjatëve dhe personave pa shtetësi (OFPRA).

Gjatë regjistrimit të kërkesës suaj të azilit, prefektura ju ka dhënë një formular kërkesë azili që duhet ta plotësoni dhe dërgoni OFPRA-s, me qëllim që ajo të mund ta shqyrtojë dhe të marrë një vendim.

Për vendimet negative të OFPRA-s mund të ketë ankesë para CNDA-s (shih 3.2. Shqyrtimi i kërkesës së azilit nga Gjykata kombëtare e të drejtës së azilit).

Gjatë dorëzimit të kërkesës suaj të azilit, ju nuk keni nevojë të saktësoni llojin e mbrojtjes që dëshironi të merrni (statusin e refugjatit ose mbrojtjen e dorës së dytë). Bëhet fjalë për një procedurë të vetme gjatë së cilës kërkesa juaj do të shqyrtohet nga OFPRA, së pari nga këndvështrimi i statusit të refugjatit, dhe pastaj, nëse situata juaj nuk i përgjigjet këtij statusi, nga këndvështrimi i mbrojtjes së dorës së dytë.

■ Formulari i OFPRA-s që duhet plotësuar.

Formulari duhet të jetë i plotësuar në frëngjisht, i nënshkruar dhe i shoqëruar nga fokotopja e dëshmisë së vlefshme të kërkesës së azilit, dy fotografi identiteti si dhe dokumenti i udhëtimit, nëse keni një të tillë.

Nëse kërkesa juaj e azilit është vendosur në procedurë të përshpejtuar, ju duhet gjithashtu të përcillni kopjen e udhëzimit të informacionit që ju është dorëzuar gjatë regjistrimit të kërkesës.


Këto dokumente janë të domosdoshme për regjistrimin e kërkesës suaj nga OFPRA.

Nëse fëmijët tuaj në moshë të mitur shoqëruar janë të ekspozuar ndaj rreziqeve personale, duhet të shkruani për këtë në formularin tuaj të kërkesës së azilit. Nëse të dy prindërit janë azilkërkues, frikët e mundshme për sa i përket fëmijëve të mitur të shoqëruar do të shkruhet në formularin e nënës.

Informacionet që përmbahen nga kërkesa juaj e azilit do të jenë të fshehta dhe nuk do t'i komunikohen në asnjë mënyre autoriteteve të vendit tuaj të prejardhjes.

■ Dërgimi i dosjes në OFPRA.

Kur dosja juaj të jetë e plotë, **ju duhet ta dërgoni, më së voni në ditën e 21-të** (ditën e 8-të në rast kërkesë rihapje – shih 3.3 Rihapja e një kërkesë azili të mbyllur – ose rishqyrtimi – shih 3.4 Rishqyrtimi) sipas lëshimit të dëshmisë suaj të kërkesës së azilit.



Ai duhet të dërgohet vetëm me anë të postës, në adresën në vijim :

OFPRA
201, rue Carnot
94 136 FONTENAY-SOUS-BOIS CEDEX

Për shembull, nëse dëshmia juaj e kërkesës së azilit është lëshuar më 10 janar, ju duhet të keni dërguar dosjen tuaj në OFPRA jo më vonë se 31 janari. Vula e postës shërben si dëshmi mbi datën.

Është thellësisht e këshillueshme që dosjen tuaj ta dërgoni me « letër të porositur me njoftim marrjeje », dukë shënuar qartësisht emrin tuaj në pjesën « dërguesi ».

Nëse dosja juaj nuk është e plotë, OFPRA jua kthen dhe ju keni një afat shtesë prej 8 ditësh për ta plotësuar dhe dërguar përsëri (4 ditë në rast kërkesë rihapje ose rishqyrtimi). Nëse nuk e dërgoni përsëri dosjen tuaj brenda këtij afati, OFPRA e mbyll kërkesën tuaj, do t'i jepet fund të drejtës suaj për të qëndruar në territor dhe dëshmia e kërkesës suaj të azilit nuk do të përtërihet më.

Gjatë gjithë kohës se procedurës, në çdo çast, ju mund t'i dërgoni OFPRA-s elemente shtesë me anë të postës. Ruani mirë një kopje të të gjitha letrave drejtuar OFPRA-s dhe ato që merrni nga kjo zyrë, gjithashtu edhe provat e dërgimit dhe marrjes së postës. Në atë rast, mos harroni që, në çdo letër të dërguar OFPRA-s, të shënoni numrin tuaj të dosjes i cili figuron në letrën e regjistrimit të kërkesës suaj të azilit e që ju është dërguar nga kjo zyrë.

Ju ndryshoni adresë gjatë procedurës ?

Nëse i keni komunikuar OFPRA-s një adresë në lidhje me vendstrehimint tuaj, e ndryshme nga adresa e vendbanimit tuaj postar, dhe nëse ndërroni vendstrehim, është e detyrueshme të informoni OFPRA-n në një afat sa më të shkurtër, është e preferueshme me anë të tele-shërbimit i disponueshëm për këtë gjë në faqen internet të OFPRA-s (www.ofpra.gouv.fr), rubrika « *Përçapjet në linjë* ». Në fakt, OFPRA ju dërgon letra në adresën e fundit që ajo e ka të ditur, sidomos kur ju thërret për intervistë apo kur ju dërgon vendimin që ka marrë mbi kërkesën tuaj të azilit.

Kur strehoeni në një banesë për të cilin jeni pronar ose qiramarrës ose në një banesë që i përket/merret me qira nga bashkëshorti/bashkëshortja/fëmija/prindi juaj, dhe nëse ndryshoni adresë, ju duhet të informoni për këtë OFII-n.


■ Prova e regjistrimit të kërkesës nga OFPRA.

Kur dosja juaj të jetë e plotë e të ketë mbërritur brenda afatit, OFPRA ju dërgon një letër me të cilën ju informon se kërkesa juaj është regjistruar pranë kësaj zyre dhe ju komunikon numrin e dosjes suaj.

Ky dokument është prova zyrtare që kërkesa juaj e azilit është regjistruar pranë OFPRA-s.

Është ky dokument që ju mundëson përtëritjen e dëshmisë suaj të parë të kërkesës së azilit (shih 2.2.1 « lëshimi i një dëshmie kërkesë azili »).

Shpeshherë, një fletëthirrje për intervistë dërgohet në të njejtën kohë me letrën e regjistrimit. Kjo thirrje për intervistë shfaqet në këtë rast në pjesën e pasme të letrës së regjistrimit. Nëse fletëthirrja nuk shfaqet në pjesën e pasme të letrës së regjistrimit, atëherë ajo do t'ju dërgohet më pas në një letër më vete.



■ Shqyrtimi i kërkesës së azilit në procedurë normale ose në procedurë të përshpejtuar.

Kërkesa juaj e azilit shqyrtohet nga OFPRA, ose në procedurë normale, ose në procedurë të përshpejtuar. Ashtu si shpjegohet në pjesën 2.2.1 (rubrika « cilësimi i kërkesës suaj të azilit »), afatet e shqyrtimit në procedurë të përshpejtuar shkurtohen në 15 ditë por ju përfitoni nga të njëjtat garanci si në procedurë normale.

Kërkesa juaj shqyrtohet nga OFPRA në procedurë të përshpejtuar kur ajo është vendosur në procedurë të përshpejtuar gjatë regjistrimit të kërkesës suaj të azilit në sportelin unik. OFPRA megjithatë ka gjithmonë të drejtën të kalojë kërkesën tuaj në procedurë normale nëse ajo e vlerëson të nevojshme sipas dosjes suaj ose situatës suaj të veçantë me përjashtim të rastit kur prania juaj në territor përbën një kërcënim të rëndë për rendin publik, sigurinë publike ose sigurinë e shtetit.

OFPRA mund të vendosë gjithashtu të marrë vendimin në procedurë të përshpejtuar në rastet në vijim :

- nëse keni paraqitur dokumente të rreme, keni dhënë indikacione të gabuara ose keni fshehur informacione ose dokumente me qëllim që OFPRA të ngatërrohet ;
- nëse keni paraqitur kërkesa të tjera azili nën identitete të ndryshme ;
- nëse keni ngritur, në mbështetje të kërkesës suaj të azilit, vetëm çështje që s'kanë të bëjnë me nevojën për mbrojtje ;
- nëse deklaratat tuaja nuk janë të lidhura mirë, kundërthënëse, haptazi të rreme ose pak të besueshme dhe janë kundërthënëse ndaj asaj që zyra e ka të ditur mbi vendit tuaj të prejardhjes.

Nëse dëshironi të kundërshtoni vënien tuaj në procedurë të përshpejtuar, këtë mund ta bëni vetëm gjatë ankesës para CNDA.

■ Intervista personale në OFPRA.

Pasi kërkesa juaj të jetë regjistruar në OFPRA, ju do të merrni një fletëthirrje për intervistë.

Mund të lirohemi nga detyrimi i intervistës vetëm në dy raste :

- nëse informacionet që i keni dorëzuar në dosjen tuaj janë të majftueshme që OFPRA t'ju njohë statusin e refugjatit ;
- kur arsye shëndetësore, që zgjasin në kohë dhe që s'varen nga vullneti juaj, ju pengojnë të paraqiteni dhe të jeni të pranishëm në intervistë.

Nëse jeni të thirrur për intervistë, duhet të shkoni në selinë e OFPRA-s, në Fontenay-sous-Bois. Aty do t'ju dëgjojë një punonjës i OFPRA-s i quajtur « oficer i mbrojtjes » dhe, në rast nevoje, në praninë e një përkthyesi i vënë në dispozicion nga OFPRA-s dhe që flet gjuhën të cilën këni zgjedhur në momentin e sportelit unik gjatë regjistrimit të kërkesës suaj të azilit ose në një gjuhë në të cilën keni njohuri të mjaftueshme (shih rubrikën « zgjedhja e gjuhës së intervistës në OFPRA në pjesën 2.2.1). Megjithatë, ju mund të kërkonit në çdo moment të merreni në pyetje në frëngjisht. Ju mund të kundërshtoni gjuhën e përdorur gjatë kësaj interviste vetëm në kuadrin e ankesës para CNDA-s.

Nëse nuk paraqiteni në këtë takim, mungesa juaj mund të bëjë OFPRA-n të marrë vendimin për sa i përket kërkesës suaj mbi bazën e dosjes suaj ose të shkaktojë mbylljen e dosjes suaj. Është pra e domosdoshme që, në rast pamundësie, të lajmëroni OFPRA-n të paktën 48 orë më herët, ose t'ia bëni me dije çdo vonesë me e-mail të dërguar në adresën e cila figuron në fletëthirrjen tuaj.

Nëse dëshironi, ju mund të paraqiteni në intervistë të shoqëruar ose nga një avokat, ose nga një përfaqësues i autorizuar i një shoqate të aftësuar nga OFPRA që do të mund të formulojë vërejtje pas intervistës. Kjo intervistë megjithatë nuk do të shtyhet nëse avokati apo përfaqësuesi i shoqatës nuk është i pranishëm në orën e caktuar në fletëthirrje. Nëse jeni në situatë handikapi, ju mund të kërkonit të jeni të



shoqëruar gjatë intervistës suaj nga profesionisti i shëndetit që ju ndjek zakonisht ose përfaqësuesi i një shoqate ndihme për personat në situatë handikapi.

Nëse, për arsye të vështirësive që t'i shpalosni motivet e kërkesës suaj, sidomos motive që kanë lidhje me dhunë të një natyre seksuale, dëshironi që intervista të zhvillohet me një punonjës të zyrës dhe/ose me një përkthyes të gjinisë të zgjedhjes suaj, ju mund t'i bëni një kërkesë të tillë OFPRA-s para ditës së intervistës.

Intervista është e fshehtë. Deklaratat tuaja do të figurojnë në një raport të përpiluar nga oficeri për mbrojtje me të cilin është zhvilluar intervista dhe i cili, nëse ju bëni një kërkesë të tillë, do t'ju komunikohet para se të merret vendimi (në procedurë normale) ose jo më vonë se në momentin e vendimit (në procedurë të përshpejtuar).

Intervistës i bëhet gjithashtu regjistrim zanor, ju mund të keni akses në këtë regjistrim zanor vetëm në rast vendimi negativ nga OFPRA dhe në kuadër të një ankese kundër këtij vendimi.

A mund të merreni në pyetje në një vend tjetër përveç selisë së OFPRA-s në Fontenay-sous-Bois ?

Mund të ndodhë që takimi juaj, për arsye të largësisë suaj gjeografike (sidomos kur ndodhëni në territoret përtej detit) ose të gjendjes suaj të veçantë (kur, për arsye shëndetësore ose familjare, nuk jeni në mundësi të lëvizni ose nëse mbaheni në një vend të privuar nga liria), të mos zhvillohet në Fontenay-sous-Bois, por në distancë, në saje të komunikimit audiovizuel.

Në këtë rast, avokati ose përfaqësuesi i shoqatës e cila ju asiston do të jetë, në rast nevojë, pranë jush. Përkthyesi do të jetë pranë oficerit për mbrojtje.

Kur gjendeni në një territor përtej detit ose në disa territore metropolitane, ju mund të dëgjoheni gjithashtu drejtpërdrejt nga një punonjës i OFPRA-s, ose në antenën e OFPRA-s në Cayenne nëse banoni në departamentin e Guyane, ose, në territoret e tjera, në kuadër të një misioni shqyrtimi të jashtëm të OFPRA-s.


■ Vizita mjekësore.

OFPRA mund t'ju kërkojë t'i nënshtroheni një vizite mjekësore. Nëse refuzoni t'i nënshtroheni kësaj vizite mjekësore kjo nuk do të konsiderohet si një shkak mosplotësimi i kërkesës suaj dhe nuk do të pengojë OFPRA-n të japë vendimin e saj. Nëse jeni në moshë të mitur dhe nëse një kërkesë azili është dorëzuar në emrin tuaj për shkak të një rreziku gjymtimi seksual, kjo vizitë mjekësore do të merret përsipër financiarisht nga OFPRA. Mjeku do t'i transmetojë drejtpërdrejt OFPRA-s çertifikatën mjekësore, dhe do t'i dorëzojë një kopje në dorë prindërve tuaj ose përfaqësuesit tuaj ligjor.

■ Vendimi i OFPRA-s.

✓ Afatet

Afatet për të marrë një vendim nga OFPRA janë të ndryshme : mesatarisht 15 ditë për një procedurë të përshpejtuar dhe deri në disa muaj në procedurë normale. Mospërgjigja e zgjatur e OFPRA-s nuk do të thotë që kërkesa juaj është refuzuar. Nëse OFPRA nuk mund të marrë vendim në afat prej 6 muajsh, ajo do t'ju informojë me letër. Duhet pra që rregullisht të verifikoni postën tuaj.



✓ **Vendimi pozitiv** (shih pjesën 1 « Format e ndryshme të mbrojtjes »)

Nëse kërkesa juaj ka marrur një vendim pozitiv, ju :

- **ose do të njiheni si refugjat**, dhe OFPRA do t'ju përcjellë në atë rast vendimin mbi njohjen e statusit të refugjatit ;
- **ose do t'ju njihet e drejta e mbrojtjes së dorës së dytë**, dhe OFPRA do t'ju përcjellë vendimin mbi të drejtën e përfitimit nga mbrojtja e dorës së dytë gjithashtu edhe një letër që ju mund të paraqisni para administratave për të justifikuar mbrojtjen tuaj.

✓ **Vendimi negativ**

OFPRA mund të marrë tre lloje vendimesh negative mbi kërkesën tuaj të azilit :

- **një vendim refuzimi ;**

Ju mund ta kundërshtoni këtë vendim para CNDA-s. Kushtet në lidhje me të drejtën e qëndrimit në territor në kuadër të azilit janë përcaktuar në rubrikën « Fundi i të drejtës së qëndrimit që nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s » në rubrikën 3.1.

- **një vendim papranueshmërie** mund të merret kur :
 - ju përfitoni tanimë nga një mbrojtje efektive që ka të bëjë me azilin në një shtet anëtar i Bashkimit europian ;
 - ju përfitoni nga statusi i refugjatit dhe një mbrojtje efektive në një shtet të tretë ku ju mund të jeni faktikisht i ripranueshëm.

Ju mund të kundërshtoni këtë vendim para CNDA-s. Ju nuk përfitoni më nga e drejta e qëndrimit në territor në kuadër të azilit, edhe në rastin kur bëni një ankesë para CNDA-s (shih « Fundi i të drejtës së qëndrimit në territor që nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s » në pjesën 3.1).

- **një vendim mbylljeje** mund të merret kur :
 - të keni informuar OFPRA-n se e keni tërhequr kërkesën tuaj të azilit me rastin e intervistës ose me letër ;
 - të mos e keni dorëzuar kërkesën tuaj në afatin e caktuar prej 21 ditësh ose të mos jeni paraqitur në intervistë ;
 - të refuzoni qëllimisht t'i jepni të dhënat themelore për shqyrtimin e kërkesës suaj ;
 - të mos mund t'ju kontaktojnë, si pasojë e mosbërjes me dije të adresës suaj zyrës në një afat të arsyeshëm.
 - kërkesa juaj është regjistruar në sportelin unik por, pa arsye legjitime, të mos e keni dërguar kërkesën tuaj OFPRA-s.

Ju mund të kundërshtoni këtë vendim, jo para CNDA-s, por para gjykatës administrative. Ju nuk përfitoni më aspak nga e drejta e qëndrimit në territor në kuadër të azilit (shih « Fundi i të drejtës së qëndrimit në territor që nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s » në pjesën 3.1). Ju mund, në një afat prej 9 muajsh që nga bërja me dije e vendimit të mbylljes dhe një herë, të kërkonit rihapjen e dosjes suaj (shih pjesën 3.3).

✓ **Modalitetet e dërgimit të vendimit të OFPRA-s**

OFPRA do t'ju dërgojë vendimin të përpiluar në frëngjisht si dhe një dokument, të përkthyer në një gjuhë për të cilën është e arsyeshme të mendohet se e kuptoni, duke ju vënë në dijeni që kërkesa juaj është refuzuar.



A mundet OFPRA t'ju dërgojë letrën e cila dëshmon për regjistrimin e procedurës suaj të azilit, thirrjen për intervistën personale dhe vendimin e saj me rrugë të çmaterializuara ?

OFPRA ka zhvilluar një dispozitiv i cili ka për qëllim dërgimin me rrugë të çmaterializuar, në një llogari personale, letrën e cila dëshmon për regjistrimin e kërkesës së azilit, thirrjen për intervistën personale dhe vendimin e saj mbi kërkesën. Ky procedim i sigurtë garanton plotësisht fshehtësinë e kërkesës së azilit.

Kur ky dispozitiv do t'ju aplikohet, ju do të informoheni për këtë gjatë regjistrimit të kërkesës suaj të azilit ose gjatë transferimit që i bëhet Francës për përgjegjësinë e shqyrtimit të kërkesës suaj të azilit nëse procedura juaj « Dublin », e përshkruar në pikën 2.2.1, ka marrë përgjigje negative. Një udhëzim informacioni mbi modalitetet e shpalosjes së dispozitivit do t'ju dorëzohet në këtë rast.

■ Ankesa kundër vendimit të OFPRA-s.

Ju mund të kundërshtoni vendimin e OFPRA-s para CNDA-s në një afat prej një muaji që nga data e njoftimit të tij (shih pjesën 3.2 « Shqyrtimi nga CNDA ». Nëse nuk keni bërë ankesë pranë CNDA-s ose nëse keni bërë një ankesë dukshëm pas këtij afati prej një muaji, e drejta juaj për qëndrim në territor merr fund, dëshmia juaj e kërkesës së azilit do t'ju tërhiqet ose nuk do t'ju përtërihet dhe ju duhet të lini Francën.

Nëse doni të përfitoni nga ndihma juridike me qëllim përgatitjen e ankesës suaj pranë CNDA-s, ju duhet ta bëni kërkesën për këtë në një afat prej 15 ditësh duke u nisur nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s. Afati i ankesës prej një muaji ndërpritet me këtë rast dhe rifillon të rrjedhë për kohën që mbetet në datën kur ju bëhet e ditur vendimi i marrë mbi ndihmën tuaj juridike (shih rubrikën « asistencë e një avokati » në pjesën 3.2).

Për vendimin e CNDA-s mund të bëhet ankesë para Këshillit të shtetit nga ju ose nga OFPRA.


■ Fundi i të drejtës për qëndrim që nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s.

Në përgjithësi, ju përfitoni nga e drejta e qëndrimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së shqyrtimit të kërkesës suaj të azilit, përfshirë ankesën ligjore.

Megjithatë, e drejta juaj e qëndrimit merr fund kur ju keni marrë një nga vendimet e OFPRA-s në vijim :

1. një vendim papranueshmërie sepse ju përfitoni tanimë nga një mbrojtje efektive në një shtet tjetër dhe, nëse ky shtet nuk është anëtar i BE-s, ju mund të ripranoheni aty (shih pjesën 3.3.) ;
2. një vendim mbylljeje (shih pjesën 3.3.) ;
3. një vendim refuzimi mbi një kërkesë azili të vendosur në procedurë të përshterjshme për arsye se jeni shtetas i një vendi me prejardhje të sigurtë ;
4. një vendim refuzimi mbi një kërkesë azili të vendosur në procedurë të përshterjshme për arsye se prania juaj në territorin kombëtar përbën një kërcënim të rëndë për rendin publik ;
5. një vendim refuzimi mbi një kërkesë rishqyrtimi e vlerësuar e pranueshme ;
6. një vendim papranueshmërie mbi një kërkesë të parë rishqyrtimi ;
7. një vendim papranueshmërie ose refuzimi kur kundër jush ka një masë dëbimi ose një ndalim territori administrativ ose gjyqësor dhe kur ju jeni detyruar të qëndroni në një vend të caktuar ose vendosur në një qendër mbajtjeje administrative (shih rubrikën « Kundër jush ka një masë dëbimi e shqiptuar nga administrata ose nga gjykata ? » në pjesën 2.2.1).

Në këtë rast, dëshmia e kërkesës së azilit mund t'ju tërhiqet ose të mos përtërihet dhe një detyrim largimi nga territori francez mund të merret ndaj jush (shih pjesën 5).



3.2. Shqyrtimi nga Gjykata kombëtare e të drejtës së azilit (CNDA).

■ Afati i ankesës.

Ju keni në dispozicion një afat prej një muaji nga momenti kur ju është njoftuar refuzimi i OFPRA-s për të dorëzuar ankesën tuaj pranë CNDA. Ju mund :

- në rast vendimi mospranueshmërie ose refuzimi nga OFPRA, t'i kërkonit Gjykatës anulimin e vendimit të zyrës dhe dhënien e një lloji mbrojtjeje ;
- në rast vendimi i cili ju jep mbrojtjen e dorës së dytë, të kërkonit njohjen e cilësisë së refugjatit. Në këtë rast, ju do të ruani përfitimin e mbrojtjes së dorës së dytë, dhe të drejtat në lidhje me këtë mbrojtje (shih pjesën 6 « Të drejtat e përfituesve të një mbrojtje »), gjatë kohës që CNDA nuk ju ka njohur cilësinë e refugjatit. Përveç kësaj, nëse CNDA nuk ju njeh cilësinë e refugjatit, ajo nuk mund të anulohet dhënien e mbrojtjes së dorës së dytë të marrë para OFPRA-s.

Kjo ankesë duhet të arrijë në CNDA para kalimit të këtij afati prej një muaji (për shembull, nëse e tërhiqni vendimin mbi refuzimin tuaj nga posta më 20 janar, ankesa juaj duhet të merret nga CNDA jo më vonë se më 21 shkurt në mesnatë). Ankesa duhet t'i dërgohet CNDA-s ose me letër të porositur me njoftim marrjeje, ose me letër të thjeshtë, ose me faks. Ankesa juaj duhet pra të jetë e dërguar, për arsye sigurie, para ditës së fundit të afatit prej një muaji ose ditën e fundit të afatit para mesnate nëse e dërgonti atë me faks. Nëse ky afat prej një muaji do të ketë kaluar në momentin e marrjes nga gjykata të ankesës suaj, kjo e fundit do të shpallet e papranueshme, gjë që do të thotë se do të hidhet poshtë pa seancë dëgjimi, dhe pa shqyrtim.

■ Ndhimja e një avokati.

Ju e keni mundësinë të ndihmoheni nga një avokat gjatë përgatitjes së ankesës suaj dhe marrjes suaj në pyetje në CNDA. Për këtë, ju mund të kërkonit të përfitoni nga ndihma juridike. Shpenzimet e avokatit merren atëherë plotësisht përsipër nga shteti, dhe avokati pra nuk ka të drejtë t'ju kërkojë honorare. Për të kërkuar ndihmën juridike, ju duhet t'i drejtoheni zyrës për ndihmë juridike të CNDA-s në një afat prej 15 ditësh nga njoftimi i vendimit refuzues të OFPRA-s.

Adresa e Zyrës për ndihmë juridike (BAJ) e CNDA-s :

Cour nationale du droit d'asile
35, rue Cuvier
93 558 MONTREUIL-SOUS-BOIS

Ju mund të tregoni emrin e një avokati që do të ketë pranuar t'i ofrojë shërbimet e tija për ndihmë juridike ose t'i kërkonit CNDA-s që t'ju caktojë një të tillë. Nëse përfitoni nga ndihma juridike, në asnjë rast nuk duhet të paguani avokatin e caktuar, edhe nëse ai jua kërkon një gjë të tillë.

Kërkesa juaj për ndihmë juridike do të mund të hidhet poshtë vetëm nëse ankesa juaj duket qartësisht e papranueshme.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës suaj për ndihmë juridike, afati për të regjistruar ankesën tuaj para CNDA -s pezullohet vetëm nëse kërkesa juaj është paraqitur brenda afatit prej 15 ditësh. Ai rifillon të rrjedhë që nga momenti i njoftimit të vendimit të marrë nga zyra për ndihmë juridike mbi kërkesën tuaj. Ju keni në këtë rast një afat të ri për të dërguar ankesën tuaj para CNDA-s, i cili është i barasvlefshëm me një muaj minus numrin e ditëve që kanë rrjedhur midis njoftimit të vendimit të OFPRA-s dhe kërkesës suaj për ndihmë juridike.



Për shembull, nëse OFPRA ju bën me dije refuzimin e saj më 15 janar, ju keni 15 ditë për të dorëzuar një kërkesë të mundshme për ndihmë juridike. Nëse ju dorëzoni kërkesën tuaj për ndihmë juridike më 20 janar, pra 5 ditë mbas bërjes me dije të vendimit të OFPRA-s, ju keni në dispozicion 26 ditë që nga vendimi i zyrës për ndihmë juridike për të bërë ankesën tuaj.

■ Ankesa.


Duhen respektuar kushtet në vijim :

- pikësëpari, lexoni mirë të gjitha shpjegimet që figurojnë në anën e prapme të vendimit refuzues të OFPRA-s ;
- ankesa duhet të jetë e shkruar në gjuhën frënge në letër të thjeshtë (nuk ka formular të parashikuar për këtë gjë) mbi të cilën do të shënoni mbiemrin, emrin, datën dhe vendin e lindjes, kombësinë dhe vendbanimin tuaj.
- duhet të nënshkruani ankesën tuaj ; nëse jeni në moshë të mitur, është përfaqësuesi juaj ligjor ai që duhet ta nënshkruajë atë ;
- duhet me patjetër që ankesës suaj t'i bashkangjisni një kopje nga vendimi i OFPRA-s ;
- nëse kërkesa juaj e azilit është vendosur në procedurë të përsheptuar, ju duhet të bashkangjisni kopjen e udhëzimit të informacionit që ju kanë dorëzuar gjatë regjistrimit të kërkesës së azilit (shih rubrikën « cilësimi i kërkesës suaj të azilit » në pjesën 2.2.1) ;
- duhet të motivoni ankesën tuaj, që do të thotë të shpjegoni pse nuk pajtoheni me arsyetimet e refuzimit të OFPRA-s ose me motivet që e kanë shtyrë OFPRA-n t'ju njohë të drejtën e përfitimit nga mbrojtja e dorës së dytë dhe jo statusin e refugjatit ;
- duhet t'i bashkangjisni dokumentat që i keni e që dëshmojnë identitetin tuaj dhe shtetësinë tuaj ;
- duhet gjithashtu t'i bashkangjisni dokumentet që e plotësojnë rrëfimin tuaj ;
- nëse dëshironi të kundërshtoni gjuhën në të cilën jeni dëgjuar në OFPRA, duhet ta saktësoni këtë në ankesën tuaj dhe duhet të saktësoni gjuhën në të cilën dëshironi të dëgjoheni. Nëse gjykata i jep të drejtë kundërshtimit tuaj dhe nuk mund të caktojë një përkthyes në gjuhën e kërkuar, ju do të dëgjoheni në një gjuhë për të cilën është e arsyeshme të mendohet se e kuptoni.
- duhet t'i ruani dëshmitë e dërgesës dhe dorëzimit të ankesës suaj, si dhe një kopje të saj ;
- ju duhet të lajmëroni CNDA-n për çdo ndryshim adrese ;
- mund të kërkontë dhënien e dosjes suaj pas regjistrimit të ankesës suaj.

Për sa i përket dokumenteve mbi shtetësinë tuaj, është e dëshirueshme t'i bashkangjisni një kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit, dhe t'i ruani origjinalet, nëse i keni, gjë që do t'ju mundësojë t'i tërhiqni nga posta letrat që do t'ju dërgohen me letër të porositur nga CNDA. Ju do të mund t'i paraqisni origjinalet ditën e seancës së dëgjimit, nëse trupi gjykues ju kërkon gjë të tillë.

Për sa i përket dokumenteve që e vërtetojnë rrëfimin tuaj, është e pëlqyeshme që origjinalet t'ia shtoni dosjes duke ruajtur një kopje. Këto dokumente do të mund t'ju kthehen ditën e marrjes në pyetje, nëse bëni një kërkesë të tillë, ose do t'ju dërgohen më tutje me postë. Dokumentet që e vërtetojnë rrëfimin tuaj duhet të jenë të përkthyer në frëngjisht. Pa përkthim, CNDA nuk do të mund t'i përdorë. Nuk është megjithatë e domosdoshme që përkthimi të bëhet nga një përkthyes i autorizuar, përveç kur bëhet fjalë për çertifikata të gjendjes civile si dhe për akte gjyqësore ose ato të lëshuara nga policia.

Ju do të mund, nëse jeni thirrur në një seancë dëgjimore publike, të jepni me shkrim informacione shtesë deri në një afat që do t'ju saktësohet në fletëthirrjen tuaj.



■ Dëshmia e marrjes së ankesës suaj.

Pas regjistrimit të ankesës suaj, CNDA do t'ju dërgojë, në adresën që do t'ia keni bërë me dije, një dokument që quhet « dëshmi marrje e ankesës ». Ky dokument vërteton se ankesa juaj është regjistruar. Përveç përjashtimeve (shih rubrikën « karakteri pezullues i ankesës » këtu poshtë, ky dokument ju mundëson të kërkonit përtëritjen e dëshmisë suaj të kërkesës së azilit, meqenëse jeni të autorizuar të qëndroni në Francë deri sa CNDA të vendosë mbi kërkesën tuaj.


■ Karakteri pezullues i ankesës.

Në mënyrë të përgjithshme, ju keni të drejtë të bëni një ankesë para CNDA-s kundër vendimit refuzues të OFPRA-s dhe kjo ankesë është automatikisht pezulluese, që do të thotë që ju vazhdoni të përfitoni nga e drejta e qëndrimit në territorin francez deri në skadimin e afatit të ankesës dhe, në rast ankese, deri në momentin kur Gjykata jep vendimin e saj.

Nëse, në të kundërt, ju humbni të drejtën për qëndrim në territorin francez para refuzimit përfundimtar të kërkesës suaj të azilit (shih rubrikën Fundi i të drejtës që nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s » në pjesën 3.1), ju ruani të drejtën të bëni një ankesë para CNDA-s kundër vendimit refuzues ose të papranueshmërisë së OFPRA-s por kjo ankesë nuk është më automatikisht pezulluese :

- ✓ **ose ankesa nuk është pezulluese** dhe një masë largimi mund të vendoset dhe të vihet në ekzekutim kur ndaj jush ka pasur një nga vendimet në vijim :
 1. një vendim papranueshmërie i OFPRA-s sepse ju përfitoni tanimë nga një mbrojtje efektive në një shtet tjetër dhe, nëse ky shtet nuk është anëtar i BE-së, ju mund të ripranoheni aty (shih pjesën 3.3.) ;
 2. një vendim mbylljeje e OFPRA-s (shih pjesën 3.3.) ;
 3. një vendim papranueshmërie e OFPRA-s mbi një kërkesë të parë rishqyrtimi të parashtruar me qëllimin e vetëm për të shmangur një masë largimi.
- ✓ **ose ankesa nuk është automatikisht pezulluese dhe ju mund t'i kërkonit gjykatës administrative të pezullojë ekzekutimin e masës së largimit të marrë kundër jush gjatë kohës së ankesës suaj pranë CNDA-s, kur ndaj jush ka pasur një nga vendimet në vijim :**
 1. një vendim refuzimi nga OFPRA mbi një kërkesë azili e vendosur në procedurë të përshpejtuar për arsye se jeni shtetas i një vendi me prejardhje të sigurtë ;
 2. një vendim refuzimi nga OFPRA mbi një kërkesë azili e vendosur në procedurë të përshpejtuar për arsye se prania juaj në territorin kombëtar përbën një kërcënim të rëndë për rendin publik.
 3. një vendim refuzimi nga OFPRA mbi një kërkesë rishqyrtimi të vlerësuar të pranueshme ;
 4. një vendim refuzimi nga OFPRA mbi një kërkesë rishqyrtimi që nuk është parashtruar me qëllim dështimin e një mase largimi ;
 5. një vendim papranueshmërie ose refuzimi kur kundër jush ka masë dëbimi ose ndalimi territori administrativ ose gjyqësor dhe kur ju jeni detyruar të qëndroni në një vend të caktuar ose vendosur në një qendër mbajtjeje administrative (shih rubrikën « Kundër jush ka masë dëbimi e shqipëtuar nga administrata ose nga gjykata ? » në pjesën 2.2.1).

Ju mund të kërkonit këtë pezullim, ose në kuadër të ankesës suaj kundër masës së largimit, ose, nëse masa e largimit ju është bërë me dije para regjistrimit të kërkesës suaj të azilit dhe kur një ankesë kundër kësaj mase largimi nuk është më e mundur, në momentin e detyrimit tuaj të mundshëm për qëndrim në një vend të caktuar ose vendosjes së mundshme në një qendër mbajtjeje administrative, në një afat prej 48 orësh pas këtij qëndrimi në një vend të caktuar ose kësaj vendosje në mbajtjeje administrative.



■ Seanca dëgjimore në CNDA.

CNDA do t'ju thërrasë për një seancë dëgjimi me qëllim shqyrtimin e kërkesës suaj. Fletëthirrja do t'ju mbërrijë, me letër, të paktën një muaj para datës së caktuar për seancë dëgjimore, përveç nëse ankesa juaj është në shqyrtim me procedurë të përsheptuar, me ç'rast do të thirreni 15 ditë para marrjes në pyetje.

Megjithatë, nëse ankesa juaj nuk paraqet elemente serioze të cilët mund të vënë në dyshim vendimin e OFPRA-s, CNDA mund, pas shqyrtimit të dosjes suaj nga një raportues, të hedhë poshtë ankesën tuaj me urdhër pa ju thirrur fare në një seancë dëgjimore.

Në një rast të tillë, seanca dëgjimore do të zhvillohet :

- ose në hapësirat e CNDA-s, që gjenden në Montreuil ose në Pallatin e drejtësisë (Ile de la Cité);
- ose me video-konferencë në hapësira që i përkasin ministrisë së drejtësisë. Fshehtësia dhe cilësia e transmetimit me video-konferencë do të jenë të garantuara.

✓ Trupi gjyqës :

Trupi gjyqës i CNDA i cili e shqyrtton ankesën tuaj drejtohet nga një magjistrat. Ai përmban gjithashtu një personalitet të kualifikuar, të emëruar nga Komisariati i lartë i Kombeve të Bashkuara për refugjatët (HCR). Trupi gjyqës shprehet mbi ankesën tuaj, pasi të kenë dëgjuar raportuesin, i cili e analizon kërkesën tuaj të azilit, pa u futur në llojin e vendimit, në bazë të sqarimeve tuaja dhe të atyre të avokatit tuaj, nëse keni një të tillë.

Kur zyra të ketë shqyrtuar me procedurë të përsheptuar dhe kur të ketë vlerësuar se kërkesa juaj është e papranueshme, i takon një gjykatësi të vetëm të CNDA të vendosë mbi ankesën tuaj në një afat prej pesë javësh.

Me nismën e vet apo me kërkesë nga ana juaj, Gjykata mund gjithmonë të vendosë të shqyrtojë kërkesën në kolegji, nëse ajo vlerëson se kërkesa nuk bie në procedurë të përsheptuar, nuk është e papranueshme, ose parashtron një vështirësi serioze.

✓ Përkthimi :


CNDA siguron praninë e një përkthyesi në gjuhën që ju e keni kërkuar gjatë kërkesës suaj të azilit (shih rubrikën « zgjedhja e gjuhës për intervistën në OFPRA ») ose, nëse nuk ka të tillë apo nëse kjo s'është e mundur, në një gjuhë për të cilën keni njohuri të mjaftueshme. Nëse doni të ankoheni për një mungesë përkthimi para OFPRA-s, ju duhet ta bëni këtë në momentin e ankesës para CNDA-s. Në rastin kur seanca juaj dëgjimore zhvillohet me komunikim audiovizual, një përkthyes është krahas jush në sallën në të cilën ju merreni në pyetje. Nëse është e vështirë të gjendet një përkthyes i disponueshëm për të qënë fizikisht pranë jush, senaca dëgjimore mund të zhvillohet vetëm pasi trupi gjyqës të ketë verifikuar që një përkthyes i tillë të jetë i disponueshëm në sallën ku trupi gjyqës gjendet.

✓ Prania juaj në seancën dëgjimore :

Prania juaj në seancën dëgjimore është thellësisht e këshillueshme. Në rast të pamundësisë ose vonesës, duhet të paralajmëroni CNDA-n. Nëse nuk mund të paraqiteni në seancë dëgjimore, mund të kërkonte që ajo të shtyhet, duke sqaruar me shkrim arsyet për të cilat nuk mund të vini. Shtyrja nuk është e drejtë që e gëzoni, i takon vetëm presidentit të trupit gjyqës pranë CNDA-s të vendosë mbi mundësinë e shtyrjes eventuale të marrjes suaj në pyetje për më tutje.

✓ Karakteri publik i seancës dëgjimore :

Marrja në pyetje është publike. Megjithatë ju mund t'i kërkonte presidentit të trupit gjyqës të shpallë seancë të mbyllur, që do të thotë që rasti juaj të shqyrtohet pa praninë e publikut. Në këtë rast, seanca e



mbyllur do të pranohet automatikisht. Presidenti i trupit gjykues mund gjithashtu të vendosë një gjë të tillë.

■ Vendimi i CNDA-s.

Që nga momenti që ajo ka marrë vendimin, CNDA ju dërgon vendimin e saj me dërgim postar « me letër të porositur me njoftim marrjeje ».

Vendimi është në gjuhën frënge, i shoqëruar me një dokument të përkthyer në një gjuhë për të cilën është e arsyeshme të mendohet se e kuptoni, duke ju treguar llojin e vendimit.

Në vendimin e saj, CNDA mund :

- të anulojë vendimin e refuzimit të OFPRA-s dhe t'ju njohë cilësinë e refugjatit ose të drejtën e përfitimit nga mbrojtja e dorës së dytë. Atëherë ju do t'i gëzoni të njëjtat të drejta sikur t'ju ishte njohur njëra nga këto mbrojtje nga OFPRA ;
- të anulojë vendimin e OFPRA-s që ju jep të drejtën e mbrojtjes së dorës së dytë dhe të zëvendësojë atë me njohjen e cilësisë së refugjatit ;
- të konfirmojë vendimin refuzues të OFPRA-s dhe të hedhë poshtë ankesën tuaj ;
- të anulojë, në disa raste, vendimin e OFPRA-s dhe t'i kërkojë të rishqyrtojë kërkesën tuaj.

Vendimi i CNDA-s mund t'i nënshtrohet ankesës për anulim vendimi, pranë Këshillit të shtetit. Ky i fundit nuk e rishqyrton plotësisht kërkesën tuaj, por vetëm disa çështje juridike të saj. Kjo procedurë është e gjatë dhe kërkon një avokat të specializuar. Ju mund të kërkonit ndihmë juridike. Kjo ankesë nuk do të mundësojë zgjatjen e qëndrimit tuaj në Francë dhe nuk do të pengojë riatdhësimin tuaj. Kur bëhet fjalë për këtë procedurë, është e dëshirueshme të merrni këshilla nga një shoqatë ose nga një avokat.

■ Fundi i të drejtës së qëndrimit pas vendimit të CNDA-s.

E drejta juaj për qëndrim merr fund :

- në momentin e leximit të vendimit të CNDA-s nëse ai merret në seancë dëgjimore publike. Megjithatë, vendimi do t'ju bëhet me dije ;
- në momentin e bërjes me dije të vendimit të CNDA-s nëse ai merret me urdhëresë.


Që nga fundi i të drejtës për qëndrim, ju duhet të lini Francën dhe kundër jush mund të ketë një detyrim largimi nga territori francez (shih pjesën 5).

3.3. Rihapja e një kërkesë azili të mbyllur.

Në rast të mbylljes së shqyrtimit të kërkesës suaj (shih rubrikën « Vendimi i OFPRA-s » në pjesën 3.1), ju mund të kërkonit, vetëm një herë, rihapjen e saj në një afat prej 9 muajsh nga vendimi i mbylljes. Për këtë, ju duhet të riparaqiteni në sturkturën e pritjes fillestare për azilkërkuesit (SPADA) dhe më pas në sportelin unik për tu regjistruar përsëri (shih pjesën 2).

Pastaj do të keni 8 ditë duke filluar nga ky regjistrim në prefekturë për të parashtruar kërkesën tuaj të rihapjes pranë OFPRA-s, e cila do të rihapë atëherë dosjen tuaj dhe do të rimarrë shqyrtimin e kërkesës suaj të azilit në po të njëjtën fazë ku ajo është ndërprerë.

Në rast të kërkesës për rihapje në afat prej 9 muajsh, ju përfitoni përsëri nga e drejta e qëndrimit në territorin francez dhe do t'ju lëshohet një dëshmi kërkesë azili.



Pasi të ketë kaluar afati prej 9 muajsh, kërkesa juaj e rihapjes do të trajtohet si një kërkesë për rishqyrtim (shih 3.4. « Rishqyrtimi »).

3.4. Rishqyrtimi.

Pas hedhjes poshtë së kërkesës suaj nga CNDA ose nëse nuk keni parashtruar ankesë në afat prej një muaji pasi ju është bërë me dije vendimi i OFPRA-s, ju mund t'i kërkonit OFPRA-s të rishqyrtojë kërkesën tuaj por vetëm nëse keni ndonjë « element të ri », i cili :

- mund të jetë i mëvonshëm ose i mëhershëm në krahasim me vendimin e CNDA-s, por të cilin e keni mësuar më vonë ;
- dhe të jetë i natyrës së tillë që të mund të arsyetojë frikën tuaj personale nga persekutimi dhe rreziqet ose kërcënimet e rënda për të cilat flisni në rast kthimi në vendin tuaj.

Ju mund të kërkonit këshilla nga një shoqatë ose nga ndonjë avokat.

Për të parashtruar një kërkesë rishqyrtimi, duhet të paraqiteni në strukturën e pritjes fillestare për azilkërkuesit (SPADA) dhe më pas në sportelin unik për tu regjistruar përsëri (shih pjesën 2).

Ju keni më pas në dispozicion një afat prej 8 ditësh nga ky regjistrim i ri për të regjistruar kërkesën tuaj për rishqyrtim pranë OFPRA-s. Nëse kërkesa juaj nuk është e plotë, zyra do t'ju kërkojë ta plotësoni atë në një afat prej 4 ditësh.

OFPRA pastaj do të bëjë shqyrtimin paraprak të kërkesës suaj dhe do të marrë një vendim mbi pranueshmërinë e saj në një afat prej 8 ditësh nga parashtrimi i saj. Gjatë këtij rishqyrtimi, jo domosdoshmërisht do të thirrreni për intervistë.

Pas përfundimit të shqyrtimit, OFPRA mund ta deklarojë të papranueshme kërkesën tuaj të rishqyrtimit nëse faktet apo elementet që i jepni nuk janë të një natyre të tillë që të mund të rrisin në mënyrë të rëndësishme mundësinë që të përfitoni nga mbrojtja.

Nëse OFPRA e deklaron të pranueshme kërkesën tuaj, ajo do të trajtohet, përveç në rast të një vendimi të kundërt, në procedurë të përshpejtuar.

Një vendim papranueshmërie ose refuzimi e marrur nga OFPRA mbi një kërkesë rishqyrtimi mund të ankimohet para CNDA-s (shih pjesën 3.2).

**A mund të përfitoni nga e drejta e qëndrimit në territor gjatë kërkesës suaj për rishqyrtim ?**

Në rast të një kërkesë të parë rishqyrtimi, (shih rubrikën « Fundi i të drejtës së qëndrimit që nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s » në pjesën 3.1) :

- nëse prefektura vlerëson se kërkesa juaj është parashtruar me qëllimin e vetëm për të shmangur një masë largimi dhe nëse OFPRA e shpall të papranueshme, ju nuk do të përfitoni më nga e drejta e qëndrimit në territor duke filluar nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s dhe një masë largimi mund të merret kundër jush dhe të vendoset në ekzekutim ;
- nëse OFPRA ka marrë një vendim papranueshmërie mbi kërkesën tuaj por nëse prefektura vlerëson se kërkesa juaj është parashtruar me qëllimin e vetëm për të shmangur një masë largimi, ju nuk do të përfitoni më nga e drejta e qëndrimit në territorin francez duke filluar nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s dhe një masë largimi mund të merret kundër jush por ju mund të kërkonti pezullimin e ekzekutimit të saj pranë gjykatës administrative gjatë kohës së ankesës suaj pranë CNDA-s ;
- nëse OFPRA ka vlerësuar të pranueshme kërkesën për rishqyrtim por i ka dhënë përgjigje negative asaj, ju nuk do të përfitoni më nga e drejta e qëndrimit në territor duke filluar nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s dhe një masë largimi mund të merret kundër jush por ju mund të kërkonti pezullimin e ekzekutimit të saj pranë gjykatës administrative gjatë kohës së ankesës suaj pranë CNDA-s.

Në rast të një kërkesë të dytë rishqyrtimi, nuk përfitoni nga e drejta e qëndrimit. Një masë largimi mund të merret kundër jush e të vendoset në ekzekutim, dhe pa pritur vendimin e OFPRA-s.



4. Kushtet materiale të pritjes së azilkërkuesit dhe të drejtat e tij

Si azilkërkues, ju keni të drejtën të përfitoni nga kushtet materiale të pritjes, të cilat përfshijnë :

- një strehim në një qendër pritje për azilkërkuesit (CADA) ose në një qendër strehimi të urgjencës, për ju dhe, dhe në një rast se keni, për anëtarët e familjes suaj (pjesa 4.1) ;
- një ndihmë financiare për azilkërkuesit (ADA), shuma e së cilës do t'i përshtatet përbërjes së familjes suaj (pjesa 4.2).

Një ofertë marrje përsipër e cila përcakton kushtet tuaja materiale të pritjes ju propozohet nga OFII gjatë takimit tuaj në sportelin unik për regjistrimin e kërkesës suaj të azilit (shih pjesën 2.2.2).

Ju përfitoni gjithashtu nga një shoqërim në përçapjet tuaja administrative dhe sociale për të siguruar ndjekjen e dosjes suaj të kërkesës së azilit gjithashtu dhe aksesin në të drejtat sociale që ju jepen, sidomos përsa i përket shkollimit, shëndetit dhe punës (pjesët 4.3 deri 4.5).

4.1. Strehimi i azilkërkuesit.


■ Vendet e strehimit.

Vendet e strehimit janë qendrat e pritjes për azilkërkuesit (CADA) dhe të gjithë strehimet e urgjencës për azilkërkuesit (HUDA). Vendet e strehimit financohen dhe koordinohen nga shteti. Ata administrohen në të shumtën e rasteve nga shoqata.

Ekzistojnë afër 100 000 vende strehimi të dedikuara për azilkërkuesit të shpërndara mbi të gjithë territorin francez, në forma apartamentesh, qendrash kolektive, ose dhomash hoteli. Në CADA ose në HUDA, është e mundur të keni nevojë t'i ndani disa hapësira (kuzhina, banjo, tualet) me persona ose familje të tjera.

Për të përfituar nga një vendstrehim, ju duhet të jeni mbajtës i një dëshmie për azilkërkues e cila është e vlefshme.

Në CADA dhe në HUDA, do të përfitoni nga një shoqërim administrativ dhe juridik (në procedurën e azilit dhe nga një shoqërim sanitar e social (hapje e të drejtave sociale, akses në shërbimet shëndetësore, në shkollimin e fëmijëve, etj.). Nëse strehoeni në dhomë hoteli, ju mund të përfitoni nga këto shoqërimet në një strukturë të pritjes fillestare për azilkërkues (SPADA).



■ Orientimi drejt strehimit.

Kushtet materiale të pritjes (CMA), që përfshijnë një ofertë strehimi dhe ndihmë financiare për azilkërkues (ADA), do t'ju propozohen nga OFII që gjendet brenda sportelit unik (GUDA) ku ju keni regjistruar kërkesën tuaj të azilit :

- **nëse refuzoni këtë ofertë marrje përsipër**, nuk do t'ju propozohet përfitimi nga kushtet materiale të pritjes.
- **nëse pranoni ofertën e marrjes përsipër**, OFII do t'ju propozojë, sipas llojit të procedurës suaj të azilit dhe sipas disponueshmërive në departament, në krahinë ose në të gjithë territorin francez, një vend në CADA ose në vendstrehim të urgjencës (HUDA).

Një strehim mund t'ju propozohet jashtë departamentit ose krahinës në të cilën keni dorëzuar kërkesën tuaj të azilit. Nëse refuzoni këtë propozim, nuk do të mund të përfitoni më nga ndihma financiare ADA dhe nuk do t'ju bëhet më asnjë propozim tjetër strehimi.

Në mungesë të vendeve të disponueshme, OFII do t'ju orientojë drejt një SPADA e cila do të kërkojë një strehim.

■ Pranimi dhe largimi nga vendi i strehimit.


Nëse jeni të pranuar në një CADA ose HUDA, ju mund të qëndroni aty gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurës suaj të azilit (OFPRA dhe CNDA).

Megjithatë, në disa situata, ju mund të qëndroni aty vetëm për një kohëzgjatje të kufizuar në përfundim të vendimit refuzues të marrë nga OFPRA (shih rubrikën « Në cilin moment do t'i jepet fund kushteve tuaja materiale të pritjes ? » në pjesën 4.2.).

Nëse jeni njohur refugjat ose përfitues i mbrojtjes së dorës së dytë (vendim përfundimtar pozitiv i OFPRA-s ose i CNDA-s), ju duhet të lini CADA-n ose HUDA-n në një afat prej tre muajsh, që mund të përtërihet një herë. Në qoftë se qëndroni në këtë vend strehimi përtej këtij afati, kundër jush mund të ketë një procedurë dëbimi nga ky strehim para gjykatësit gjyqësor.

Nëse kërkesa juaj e azilit është hedhur poshtë (vendim përfundimtar negativ i OFPRA-s ose i CNDA-s), ju duhet të lini medoemos CADA-n ose HUDA-n në momentin e skadimit të së drejtës suaj të qëndrimit në territor (shih rubrikat « fundi i të drejtës së qëndrimit » në pjesët 3.1 dhe 3.2), përveç përjashtimeve të parashikuara nga ligji.

Në qoftë se qëndroni në këtë vend strehimi përtej këtij afati, kundër jush mund të ketë një procedurë dëbimi nga ky strehim. Në këtë kuadër, ju do të urdhëroheni nga prefekti i departamentit, ose administratori i CADA-s ose i HUDA-s të lironi vendin tuaj. Në hipotezën kur ju nuk e beni këtë gjë, prefekti i departamentit, ose administratori, mund t'i kërkojë gjykatësit administrativ që t'ju urdhërojë të lironi vendin. Në qoftë se është e nevojshme, forcat e rendit të policisë kombëtare ose të xhendarmërisë do t'ju dëbojnë.



4.2. Ndhimja financiare për azilkërkues (ADA).

Administrimi i ndihmës financiare për azilkërkuesit (ADA) sigurohet nga OFII dhe pagesa nga Agjencia e shërbimeve të pagesës.

Kjo ndihmë ju derdhet, me anë të një karte të lëshuar nga OFII, gjatë kohës kur ju përfitoni, si azilkërkues, nga e drejta e qëndrimit në territor ose deri në transferimin efektiv drejt një shteti tjetër përgjegjës për kërkesën tuaj të azilit.

■ Kushtet për të përfituar nga kjo ndihmë.

Për të përfituar nga ndihma financiare për azilkërkues, ju duhet :

- 1- të jeni të pajisur me dëshmi të kërkesës së azilit ;
- 2- të keni moshën 18 vjeç ;
- 3- nëse jeni azilkërkues, t'i keni pranuar kushtet materiale të pritjes të propozuara nga OFII gjatë takimit tuaj në sportelin unik.

A mundem të përfitoj nga kushtet materiale të pritjes pa pasur dëshmi të kërkesës së azilit ?

Ashtu si saktësohet më lartë, për të përfituar nga kushtet materiale të pritjes, ju duhet të jeni të pajisur me një dëshmi të kërkesës së azilit e cila është e vlefshme.


Megjithatë, përfitimi i kushteve materiale të pritjes mund t'ju refuzohet nëse keni paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e kërkesës suaj të azilit ose nëse e keni kërkuar ndihmën financiare për azilkërkues me shumë vonesë, pa arsye legjitime (shih rubrikën « cilësimi i kërkesës suaj të azilit » në pjesën 2.2.1), edhe pse jeni të pajisur me dëshmi të kërkesës së azilit.

Gjithashtu, azilkërkuesit, dëshmia e kërkesës së azilit të së cilëve është tërhequr ose nuk është përtëritur pas një vendimi refuzues i OFPRA-s mbi një kërkesë azili të vendosur në procedurë të përshpejtuar për disa arsye (vend me prejardhje të sigurtë, kërcënim i rëndë i rendit publik), vazhdojnë të përfitojnë nga kushtet materiale të pritjes pas vendimit të OFPRA-s, dhe në rast ankese para CNDA-s, deri në momentin kur një gjykatës të jetë shprehur mbi situatën (gjykatës administrativ ose gjykatës i azilit). Duhet vënë re se, në këto raste, ndihma financiare mund të përshtatet ose zëvendësohet nga ndihma materiale.

■ Formulimi i kërkesës.

Nëse jeni azilkërkues, e drejta për ndihmë financiare për azilkërkues hapet, pas regjistrimit të kërkesës suaj të azilit në sportelin unik dhe nëse pranoni ofertën e marrjes përsipër që do t'ju paraqitet nga OFII.

Derdhja e ndihmës financiare do të fillojë vetëm pas dorëzimit të kërkesës suaj të azilit pranë OFPRA-s, në një afat maksimal prej 21 ditësh pas regjistrimit të kërkesës suaj të azilit.



■ Shuma e ndihmës financiare.

Për të përfituar nga ndihma financiare e azilkërkuesit, ju duhet të dëshmoni se të ardhurat tuaja mujore janë më të ulëta se shuma e pagesës së solidaritetit aktiv (RSA).

Shuma e ndihmës financiare llogaritet në bazë të një tablele që merr parasysh përbërjen tuaj familjare, të ardhurat tuaja dhe llojin e strehimit.

■ Derdhja.

Derdhja e parë e ndihmës financiare për azilkërkues vjen pasi të keni dorëzuar kërkesën tuaj të azilit pranë OFPRA-s. Nëse i keni komunikuar një numër celulari OFII-t, ju do të informoheni për mbushjen e kartës suaj me SMS.

Ndihma financiare do t'ju derdhet deri në fund të muajit gjatë së cilit merr fund e drejta juaj për qëndrim në territorin francez (shih rubrikat « Fundi i të drejtës së qëndrimit » në pjesët 3.1 dhe 3.2).

Derdhja e ndihmës financiare ndërpritet në fund të muajit që vjen pas atij kur ju është njoftuar vendimi përfundimtar lidhur me kërkesën e azilit.

■ Ankesa.

Ju duhet detyrimisht të njoftoni OFII-n mbi çdo ndryshim adrese që mund të ketë ndodhur në rastin tuaj, qoftë për sa i përket të drejtës suaj të qëndrimit, gjendjes suaj familjare, të ardhurave tuaja, apo vendit tuaj të punës.

Në rast kundërshtimi të një vendimi që ka të bëjë me ADA-n të marrë nga OFII, ju takon juve të parashtroni ankesë vullnetare pranë OFII-t, duke qenë se gjykata administrative, nga ana e saj, është kompetente në rast ankese me mosmarrëveshje.

Në çfarë momenti do t'i jepet fund kushteve tuaja materiale të pritjes ?


Përftimi nga kushtet materiale të pritjes përfundon në fund të muajit në të cilin ka përfunduar e drejta juaj e qëndrimit në territor në kuadër të azilit.

Azilkërkuesit, e drejta e qëndrimit të së cilëve ka marrë fund pas një vendimi refuzues të OFPRA-s mbi një kërkesë azili të vendosur në procedurë të përsheptuar për disa arsye (vend me prejardhje të sigurtë, kërcënim i rëndë i rendit publik), përfitojnë nga kushtet materiale të pritjes deri në momentin kur gjykata të hedhë poshtë kërkesën për pezullim të ekzekutimit të masës së largimit ose deri në momentin e marrjes së vendimit të CNDA-s (shih pjesën 5.1).

Nëse jeni njohur si refugjat ose jeni pranuar si përfitues i mbrojtjes së dorës së dytë, përfitimi nga ndihma financiare përfundon në fund të muajit që ndjek muajin kur ju bëhet njoftimi i vendimit.

Megjithatë, mund t'i jepet fund kushteve materiale të pritjes kur :

- pa arsye legjitime, ju keni braktisur vendstrehimin tuaj ;
- nuk keni respektuar detyrimin për paraqitje tek autoritetet, nuk i jeni përgjigjur kërkesave për informacion ose nuk keni shkuar në takimet personale në lidhje me procedurën e azilit ;
- jeni orientuar nga OFII drejt një vendstrehimi ose një SPADA në një krahinë tjetër por ju nuk paraqiteni aty në afatin e detyrueshëm prej pesë ditësh ;
- jeni orientuar nga OFII në një krahinë tjetër dhe ju e lini atë pa autorizimin e OFII-t.
- keni fshehur të ardhurat tuaja financiare ;
- keni dhënë informacione të rreme në lidhje me gjendjen tuaj familjare ;



- keni paraqitur kërkesa azili të shumta nën identitete të ndryshme ;
- keni pasur një sjellje të dhunshme ose nuk e keni respektuar rregulloren e vendstrehimit tuaj në një mënyrë të rëndë.

Vendimi do të merret pasi të ju jetë dhënë mundësia t'i paraqisni OFII-t vërejtjet tuaja me shkrim. Vendimi do të mund të shkaktojë, në raste fshehje të ardhurash financiare, dhënie informacionesh të rreme në lidhje me gjendjen tuaj familjare dhe paraqitjen e disa kërkesave azili nën identitete të ndryshme, kthimin e shumave të derdhura me të padrejtë.

4.3. Aksesit në shkollim.

Aksesit në sistemin e shkollimit për fëmijët e azilkërkuesve është e njëjtë me atë rezervuar qytetarëve francezë.

Në përputhje me kodin e edukimit (neni L. 111-2) « çdo fëmijë ka të drejtë të ketë një formim shkollor i cili, duke e plotësuar veprimtarinë e familjes, jep kontribut në edukimin e tij ». Ai sjell ndërmend faktin që : « Shkollimi është i detyrueshëm për fëmijët e të dyja gjinive, francezë dhe të huaj, brenda moshës 6 deri 16 vjeç » (neni L. 131-1 i kodit të lartpërmendur).

Regjistrimi në shkollën fillore bëhet pranë bashkisë. Ju duhet t'i paraqisni dokumentet që dëshmojnë bijësinë e fëmijës suaj, vendbanimin tuaj dhe faktin që fëmija i ka bërë të gjitha vaksinat e moshës së tij. Regjistrimi në një institucion të shkollimit të mesëm (kolegj apo gjimnaz) bëhet drejtpërsëdrejti pranë institucionit më të afërt nga vendbanimi juaj.

Struktura të cilës i është ngarkuar shoqërimi juaj administrativ, juridik dhe social, qoftë struktura që ka përsipër strehimin tuaj, qoftë ndonjë shoqatë e pritjes së parë (SPADA) që ka nënshkruar marrëveshje me OFII-n (shih pikën 2.1), mund t'ju japë ndihmë në përmbushjen e këtyre përçapjeve.

4.4. Aksesit në shërbimet shëndetësore.

■ Ku të drejtoheni për shërbimet shëndetësore ?

- **Tek një profesionist i shëndetit (jashtë spitaleve)**


Për çdo problem shëndetësor, ju mund të konsultoni një mjek « të përgjithshëm » i cili do t'ju ekzaminojë dhe do t'ju japë receta për barnat që ju nevojiten. Ai do t'ju orientojë drejt një mjeku « specialist » ose drejt një ndihmës mjekësor (infirmier, fizioterapist...) nëse keni nevojë për vizita ose shërbime shëndetësore plotësuese.

- **Në farmaci** : për të blerë barnat, ose për të kërkuar këshilla.
- **Në spital** : në rast urgjence, ose me takim për disa lloje vizitash apo konsultash specialistësh.

Këto shërbime shëndetësore janë me pagesë, por ato mund të merren përsipër nga mbrojtja shëndetësore (shih paragrafin vijues).

Në pritje të sigurmimit tuaj shëndetësor, ju mund të përfitoni nga shërbimet shëndetësore falas në strukturat vijuese :

- Për të gjitha shërbimet shëndetësore :



- ju mund të drejtoheni pranë permanencave të aksesit të shërbimeve shëndetësore (PASS) që gjenden në përgjithësi në spital. Ju do të merreni nën përkujdesje nga mjekët dhe do t'ju jepen barna falas.
- Disa shoqata të specializuara (Médecins de Monde, le COMEDE...) propozojnë falas konsulta mjekësie të përgjithshme, konsulta stomatologjike, ose konsulta të specializuara (ginekologjike, oftalmologjike ose psikologjike, etj.).
- Për probleme specifike :
 - Për ndjekjen e shtatëzanisë së grave shtatëzëna, ndjekjen dhe vaksinimin e fëmijëve më të vegjël se 6 vjeç : në qendër të PMI (Mbrojtja e nënës dhe e fëmijës)
 - Për depistimin e tuberkulozit : në CLAT (qendër e luftës kundër tuberkulozit)
 - Për depistimin e HIV, hepatiteve dhe infektiveve seksualisht të transmetueshme : në Qendrat falas të informacionit, depistimit dhe diagnostikës (CeGIDD)
 - Për lëshimin e mjeteve kontraceptive : në qendrën e planifikimit familjar (CPEF)
 - Për varësitë ndaj drogave : në Qendrën e kurimeve, shoqërimit dhe paralajmërimit në adiktologji (CSAPA)

Informohuni pranë strukturës suaj të pritjes fillestare, qendrës suaj të strehimit ose spitalit vendor për të mësuar ku të gjeni këto shërbime, ku të shkoni për konsultë <http://annuaresante.ameli.fr>

Në rast urgjence shëndetësore, i telefononi 15-ës ose 112-ës, ose shkoni në urgjencën e spitalit më të afërt nëse nuk mundeni të telefononi.

■ Si të fitoni marrjen përsipër të shpenzimeve tuaja shëndetësore ?


Në Francë, shërbimet shëndetësore janë me pagesë, por ju mund të përfitoni nga mbrojtja shëndetësore e cila do të marrë përsipër të gjitha ose një pjesë të shpenzimeve tuaja shëndetësore.

Bëhet fjalë për mbrojtjen shëndetësore universale (PUMa) dhe për Plotësuesen shëndetësore solidare (CSS). Kjo e fundit jepet në bazë të të ardhurave.

Këto dispozitive ju mbulojnë për të gjitha shërbimet shëndetësore të përditëshme, duke përfshirë syzet, protezat dentare etj. Plus, Plotësuesja shëndetësore solidare ju lejon të përfitoni nga këto shërbime shëndetësore pa avancuar lekë, dhe nga ulje çmimesh për shpenzimet tuaja të transporteve.

Ju mund të bëni kërkesë për këtë pranë arkës themelore të sigurimit shëndetësor (CPAM) të departamentit tuaj të banimit :

- **që nga regjistrimi i kërkesës suaj të azilit për fëmijët tuaj në moshë të mitur** : mjafton që të plotësoni formularët e « Kërkesës së hapjes të të drejtave për siguracionin shëndetësor » dhe e « Kërkesës për Plotësuesen shëndetësore solidare » dhe të bashkangjisni dëshminë e kërkesës së azilit mbi të cilët ata figurojnë ;
- **pas 3 muajsh banimi në francë për veten tuaj (ose bashkëshortin/ten tuaj)** : ju duhet në këtë rast të plotësoni përsëri këta formularë dhe t'i bashkangjisni atyre, plus dëshmisë suaj të kërkesës së azilit, një dokument që vërteton për banimin tuaj në Francë prej më shumë se 3 muaj, për shembull :
 - dëshminë e strehimit të bërë nga një qendër strehimi për 3 muajt e fundit ; dëshminë e vendbanimit që daton prej më shumë se 3 muaj ; dëshminë e kërkesës së azilit që daton prej më shumë se 3 muaj ; çdo dokument të dhënë nga struktura e pritjes fillestare të azilkërkuesve (SPADA) që daton prej më shumë se 3 muaj ; në rast strehimi tek një i tretë, një dëshmi mbi nderin të këtij personi ku është saktësuar data e fillimit të strehimit me dokumentet vërtetues të banesës (vërtetim pagese qeraje, fatura energjie...) në emer të tij për 3 muajt e fundit, etj.



Nëse ju ose fëmijët tuaj keni nevojë të kuroheni shpejt, ju mund të bashkangjisni një certifikatë e cila flet për nevojën tuaj për mjekim të shpejtë, në mënyrë që dosja juaj të shqyrtohet më shpejt dhe të përfitoni nga mbrojtja juaj shëndetësore më shpejt.

Ju mund të ndimoheni në këtë përçapje nga struktura juaj e pritjes fillestare (SPADA), nga qendra juaj e strehimit (CADA, HUDA...) ose gjithashtu edhe nga shërbimi social i një spitali.

Mbrojtja juaj shëndetësore do të fillojë në datën në të cilën percillni dosjen tuaj CPAM-s. Pra është e rëndësishme të bëni kërkesën tuaj pa pritje për fëmijët tuaj (që nga regjistrimi i kërkesës suaj të azilit), dhe që nga momenti kur ju do të mund të justifikoni për një banim prej 3 muajsh në Francë për veten tuaj ose për bashkëshortin/ten tuaj.

Ju do të merrni një dëshmi që duhet të paraqisni tek mjeku, në spital ose në farmaci për të përfituar nga shërbimet shëndetësore. Ajo do t'ju dërgohet nga arka në adresën e shënuar në formularë : ju duhet të shkruani në formular adresën e vendbanimit tuaj.

Ju do të jeni i mbuluar gjatë të gjithë periudhës së kërkesës së azilit, dhe me pas nëse përfitoni nga mbrojtja ndërkombëtare. Meqënëse Plotësuesja shëndetësore solidare është e vlefshme 1 vit, ju duhet të dorëzoni çdo vit një dosje të re në mënyrë që të vazhdoni të përfitoni nga ajo, preferohet midis 4 dhe 2 muaj para datës së fundit të të drejtës e cila figuron mbi dëshminë tuaj.

Në pritje të hapjes të të drejtave tuaja, ju mund të merreni përsipër pa pagesë për shërbimet shëndetësore të përditëshme në strukturat pa pagesë të shënuara në pjesën e mëparshme « Ku të drejtoheni për shërbimet shëndetësore ?


« Shërbimet tuaja shëndetësore urgjente » në spital do të merren gjithashtu përsipër. Bëhet fjalë për shërbime shëndetësore të cilat nuk mund të presin, për shembull : shërbime për një plagë të rëndë, një thyerje, një djegje, një sëmundje e rëndë ose e transmetueshme, të gjitha shërbimet shëndetësore për moshat e mitura ose gratë shtatzëna (gjithashtu ekzaminimet parandaluese të realizuara gjatë dhe pas shtatzënisë, lindja, ndërprerja e shtatzënisë...) **Ju duhet të paraqisni dëshminë tuaj të kërkesës së azilit kur të vini në spital për tu kuruar pa pagesë.**

MBANI MEND :

Ju kërkoni mbrojtjen shëndetësore pranë CPAM-s të vendbanimit tuaj që nga regjistrimi i kërkesës suaj të azilit për fëmijët tuaj në moshë të mitur, dhe për veten tuaj (ose bashkëshortin tuaj) që nga momenti kur banoni në Francë prej më shumë se 3 muaj.

Ne pritje të përfitimit të mbulesës suaj shëndetësore, ju mund të gjeni shërbime shëndetësore falas në disa struktura shëndetësore ose për « shërbimet shëndetësore urgjente » në spital : ju paraqisni dëshminë tuaj të kërkesës së azilit.

Ju informoni CPAM-n tuaj për çdo ndryshim situatë : ju dërgoni një kopje të çdo dëshmie të re kërkesë azili, dhe një kopje të vërtetimit (récépissé) të kërkesës së lejes së qëndrimit nëse ju fitoni mbrojtjen ndërkombëtare.



4.5. Aksesit në tregun e punës.

Si azilkërkues, ju mund të jeni të autorizuar të punoni kur OFPRA, për arsye që nuk kanë të bëjnë me ju, nuk ka vendosur mbi kërkesën tuaj të azilit në një afat prej gjashtë muajsh nga parashtrimi i kërkesës suaj të azilit.

Në këtë rast, ju do të mundeni, pasi të keni paraqitur kërkesën e autorizimit për punë të hartuar nga punëdhënësi juaj i ardhshëm, të kërkonte një autorizim për punë pranë shërbimit të punëtorëve (SMOE) të DIRECCTE të departamentit të vendbanimit tuaj.

Vendimi që ka të bëjë me kërkesën për autorizim për punë merret nga prefekti/DIRECCTE/SMOE, që ka në dispozicion një afat shqyrtimi prej dy muajsh nga kërkesa juaj. Nëse nuk merrni përgjigje brenda këtij afati, autorizimi konsiderohet i marrë. Ai i bëhet me dije punëdhënësit tuaj të ardhshëm dhe juve gjithashtu, dhe është e vlefshme për kohëgjatësinë e së drejtës suaj për qëndrim në territor.

Nëse pajtohet, prefekti do të dërgojë autorizimin për punë që ka të bëjë me kontrata pune më të gjata se 3 muaj ose mbi kontrata pune sezonale në OFII.

Ky autorizim megjithatë mund t'ju refuzohet, sidomos në varësi të situatës së punësimit në krahinë ose sektorin në fjalë, përveç nëse aplikoni për një punë që figuron në njërin nga listat e profesioneve, rekrutimi i të cilave karakterizohet me vështirësi të shprehura.

Nëse jeni të pajisur me autorizim të përkohshëm për punë dhe në rast të ndërprerjes së kontratës suaj të punës për një arsye që nuk ka të bëjë me ju ose pasi të ketë përfunduar kontrata me kohë të caktuar ose kontrata për zëvendësim (interim), ju mund të kërkonte të jeni të regjistruar si punëkërkues, pranë Polit të punësimit (Pôle emploi).

Nëse jeni i mitur i pashoqëruar dhe nëse përfitoni nga një autorizim pune për përfundimin e një kontrate shkolle profesionale ose profesionalizimi me kohë të caktuar, ju mund të vazhdoni kontratën tuaj nëse dorëzoni dosjen tuaj që nga 1 marsi 2019.

Se fundmi, nëse jeni të pranuar në tregun e punës, ju do të mund gjithashtu të përfitoni, në kushtet e parashikuara nga kodi i punës, nga veprimtari të formimit profesional.



5. Pasojat e refuzimit të kërkesës së azilit mbi të drejtën e qëndrimit në territor

5.1. Vendimi i refuzimit nga OFPRA ose nga CNDA.

■ Fundi i të drejtës së qëndrimit që nga njoftimi i vendimit të OFPRA-s.

✓ Ankesa pranë CNDA-s nuk është pezulluese :

Ashtu si shpjegohet në pjesën 3.1, e drejta juaj për qëndrim në territorin kombëtar merr fund kur ju keni marrë një nga përgjigjet e OFPRA-s në vijim :

1. një vendim papranueshmërie i OFPRA-s sepse ju përfitoni tanimë nga një mbrojtje efektive në një shtet tjetër dhe, nëse ky shtet nuk është anëtar i BE-së, ju mund të ripranoheni aty (shih pjesën 3.3.) ;
2. një vendim mbylljeje (shih pjesën 3.3.);
3. një vendim papranueshmërie e OFPRA-s mbi një kërkesë të parë rishqyrtimi të parashtuar atëherë kur kundër jush kishte një masë largimi.

Në këtë rast, dëshmia e kërkesës së azilit mund t'ju tërhiqet ose të mos t'ju përtërihet dhe një detyrim për të lënë territorin francez mund të merret kundër jush. Ankesa para CNDA-s nuk është pezulluese dhe masa e largimit mund të vendoset në ekzekutim në çdo moment.

Nëse keni informuar OFPRA-n për tërheqjen e kërkesës suaj të azilit, ju humbni gjithashtu të drejtën për qëndrim dhe ankesa para CNDA-s nuk është pezulluese.


✓ Ankesa pranë CNDA-s nuk është automatikisht pezulluese :

E drejta juaj për qëndrim në territorin kombëtar merr gjithashtu fund kur ju keni marrë një nga përgjigjet e OFPRA-s në vijim :

1. një vendim papranueshmërie mbi një kërkesë të parë rishqyrtimi kur kundër jush nuk ka masë largimi ;
2. një vendim refuzimi mbi një kërkesë rishqyrtimi të vlerësuar të pranueshme ;
3. një vendim refuzimi mbi një kërkesë azili të vendosur në procedurë të përshpejtuar për arsye se jeni shtetas i një vendi me prejardhje të sigurtë ;
4. një vendim refuzimi mbi një kërkesë azili të vendosur në procedurë të përshpejtuar për arsye se prezenca juaj në territorin kombëtar përbën një kërcënim të rëndë për rendin publik ;
5. një vendim papranueshmërie ose refuzimi kur kundër jush ka masë dëbimi ose ndalimi territori administrativ ose gjyqësor dhe kur jeni detyruar të qëndroni në një vend të caktuar apo vendosur në një qendër mbajtjeje administrative (shih rubrikën « Kundër jush ka masë dëbimi, një ndalim territori shqiptuar nga administrata ose nga gjykata ? » në pjesën 2.2.1).

Në rastet 1 deri në 4, dëshmia e kërkesës së azilit mund t'ju tërhiqet ose të mos t'ju përtërihet dhe një detyrim për të lënë territorin francez (OQTF) mund të merret kundër jush.

